GAZETA SHQIPTARE

Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXIV - Nr. 7492 E diel 8 Prill 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

KORÇA BEER edhe sot më e mira ...

Opinioni i Ditës

Nga JORGJI KOTE

Mësime nga zhgënjime "emblematike"

Më 6 prill 2017, Gjykata e Lartë e Koresë së Jugut dënoi përfundimisht me 24 vite burg dhe gjobë 17 milionë euro ish-presidenten karizmatike 66-vjeçare ...

Vijon në faqen 21

Dje në "Deutsche Welle"

Nga CRISTIAN STEFANESCU

Lamtumirë Rumani - frika e politikanëve nga drejtësia

Rasti më i njohur në Rumani është ai i Sebastian Ghitas, 40 vjeç, i njohur si "Enfant terrible" - gjeni i industrisë informatike në Rumani. Në dhjetorin ...

Vijon në faqen 22

Ambasadori Lu e quajti "peshk të madh"

Artan Hoxha: Balili s'ka besim në gjykim të drejtë, dorëzohet po shkoi dosja në gjyq

Gazetari: Dyshimi, anëtarët e klanit Çapja në Elbasan trafikuan sasi të mëdha droge

Pas deklaratës së ambasadorit amerikan Donald Lu se i ashtuquajturi "Eskobar i Ballkanit", Klement Balili fshihet në Shqipëri dhe se së shpejti këtë "peshk të madh" do mund ta shihnim në "rrjetë", vjen një tjetër deklaratë e fortë nga gazetari i kronikës Artan Hoxha ...

Në faqen 11

KRYEBASHKIAKU I KUKESIT: PSE NUK I SHKOVA KRYEMINISTRIT NE TAKIM

PROTESTE TEK RAMA: BOLL ME DHUNE, NUK JEMI DELE

Qindra qytetarë marshojë para Kryeministrisë, "i vendosin traun" Ramës. Kreu i Bashkisë së Kukësit: Ja propozimet tona për taksën e Rrugës së Kombit

(Në foto) Qytetarë me pankarta gjatë një proteste të Shoqërisë Civile

Në faqet 2-3

SKEMA E TVSH

Arben Ahmetaj, urdhër Tatimeve: Mos e gjobisni biznesin e vogël

Në faqen 5

DYSHIMI

Shkrumbohet makina në Vlorë, i zoti: Gjeta bidon benzine

Në faqen 6

PRESIDENTI I "ISJ"

Regjimi iranian, fushatë kundër muxhahedinëve në Shqipëri

Në faqen 6

PERFITUESIT

ALUIZNI: 280 familjet që kanë gati lejet e legalizimeve

Në faqen 8

MONO Publikohen për herë të parë kujtimet e postkomandantit Qazim Onuzi për "7 prillin"

Ditari i oficerit që e priti Italinë me armë më 1939

Në brendësi: Dhuna verbale për Tepelenën, nga Ben Andoni. Apeli, biblioteka e Joklit në Shqipëri

Nga PETRIT PALUSHI

Në librin "Dëshmi e rrallë" (7 prill 1939), mbas 79 vjetësh botohen materiale nga "Shënime mbi jetëshkrim" të Qazim M. Ahmetit (Onuzi), prej katundit Nangë (Rrethi Kukës). Ato japin kryesisht atmosferë lufte të 7 prillit dramatik të 1939-s, por dhe një jetëshkrim të pasur të Qazim M. Onuzit kur shërbente në Gjandarmërinë shqiptare para dhe pas kësaj kohe, derisa doli në lirim për arsye shëndetësore me 20 dhjetor të 1939-s. Qysh në fillim të fletores, autori shpall synimin e vet të kthjellët: Në ket tefterë do t'përshkruejmë me ekzaktësi jetëshkrimin t'onë tue cilsue vuejtjet e rinis s'ime gjatë kohës okupacjoneve e revolucjoneve barbarike". Fletorja përmban 40 faqe me shënime. Le të jetë kjo paraqitje ...



Suplement

PROTESTA
REAGIMET

Kryetari i PD-së takon artistët, kundër prishjes së Teatrit Kombëtar

Basha: Opozita do të mbrojmë artin, Rama kundër ligjit

Kryetari i PD-së, Lulzim Basha priti dje një përfaqësi të aktorëve, me të cilët bisedoi për shembjen e godinës së Teatrit Kombëtar nga qeveria. Basha tha pas takimit se, "si opozitë jemi revoltuar për rikthimin e këtij projekti, shkatërrimin e Teatrit Kombëtar në funksion të ndërtimit të kullës apo të kullave dhe të një afere korruptive. Partia Demokratike është kundër prishjes së Teatrit Kombëtar, Partia Demokratike do të qëndrojë fuqishëm në krah të artistëve dhe u bën thirrje qytetarëve, artdashësve t'i bashkohen protestës së tyre legjitime. Ajo që Edi Rama po bën është e kundraligjshme, është korruptive, është kriminale. Qëndresa që po bëjnë artistët është e drejtë jo vetëm për ta dhe për Teatrin, por për

kujtesën kombëtare, për kujtesën historike të qytetit, për të sotmen dhe të nesërmen e qytetit të Tiranës dhe të mbarë vendit", tha Basha. "Ne, opozita do të ndërtojmë së bashku me artistët shqiptarë një projekt kombëtar për artin dhe kulturën, do ta propozojmë këtë në parlament, do ta mbrojmë me të gjitha fuqitë dhe mënyrat tona dhe padyshim nuk do të jetë largët dita kur shqiptarët do ta aprovojnë dhe miratojnë këtë projekt kombëtar për artin dhe kulturën", sqaroi Basha. Kreu i PD-së u shpreh: "Teatri nuk do të shembet. Ne do të jemi aty me të gjithë forcën tonë për të bërë gjithçka është e nevojshme për t'iu kundërvënë këtij projekti korruptiv. Trualli i teatrit, godina e teatrit nuk duhet të tjetërsohet, por duhet të mbeten ashtu siç janë dhe natyrisht, duhet të investohet për të përmirësuar infrastrukturën, e cila qëllimisht është rrënuar për të justifikuar pastaj prishjen e tij".

Protestat e dhunshme, kryebashkiaku i Kukësit i kujton kryeministrit: Kuksianët e kanë faljen institucion

Bashkim Shehu: Pse nuk i shkova Ramës në zyrë

Ja propozimet për taksën e rrugës, informova edhe presidentin

Kreu i Bashkisë së Kukësit, Bashkim Shehu foli dje për bisedat me kryeministrin Edi Rama, duke shprehur kritika për mënyrën se si ai ka komunikuar me qytetarët e Kukësit. I ftuar në emisionin "Kjo Javë" të gazetares Nisida Tufa në "News 24", Shehu tha se nuk i shkoi në takim kreut të qeverisë pas ftesës së tij, pas arrestimit të 23 personave lidhur me këtë ngjarje.

Si e përjetuat protestën të shtunën e kaluar?

Ishte një ditë shumë e vështirë për banorët e Kukësit. Nuk dua të përqendrohem shumë tek ajo ditë, sepse dua të sqaroj opinionin publik, pasi kemi pasur disa nisma para se të shkohej te kjo protestë. Ka qenë një reagim i imi dy ditë përpara, një mbledhjeje mes dy qeverive, asaj të Kosovës dhe Shqipërisë. U bëra thirrje të dy kryeministrave të bënin kujdes dhe të shikonin hapësirat që qytetarët e Kukësit të përjashtoheshin nga kjo taksë, pasi gjendja e tyre ekonomike nuk është e mirë. Kanë qenë shoqatat e biznesit të Kukësit, më kanë ftuar dhe unë kam shkuar, kemi diskutuar se si mund

Kreu i Bashkisë së Kukësit, Bashkim Shehu

të gjendet zgjidhje. Ka qenë edhe një takim i imi me kryeministrin, ku i kam kërkuar që të zerohet, të mos ketë taksë për Kukësin.

Kur e keni takuar kryeministrin?

Vetëm vjet ne kemi pasur 27 takime si kryetarë bashkish me ministra të ndryshëm, por me kryeministrin ka qenë në zyrë.

Ka qenë një takim vetëm mes ju të dyve?

Po, dhe unë i kam kërkuar që Kukësi duhet ta kishte zero dhe më ka premtuar që do ta shikojë me përparësi dhe do ta ketë kujdes. Kjo ka qenë një çështje mbi dyvjeçare që ne kemi reaguar.

Më pas nuk morët asnjë informacion derisa u vendosën sportelet?

Në dijeninë time, kanë vazhduar dhe nuk ka qenë shumë e qartë se çfarë po ndodhte. Unë herë pas here kam kërkuar edhe informacion se çfarë po ndodhte, sepse ishte diçka për herë të parë. Kemi biseduar edhe me qytetarë dhe kemi pritur të kishte edhe biseda me qytetarët.

Kur patë që nuk kishte më informacione, ju vendosët që të protestohej. A ishin dakord të gjithë anëtarët e këshillit bashkiak që të protestohej?

Unë nuk kam vendosur që të protestoj. Unë kam qenë pjesë e reagimeve të mia personale dhe kam ruajtur linjën institucionale të reagimeve të mia. Normalisht ne duhet të informonim qytetarët, sepse është një ndryshim drastik në jetën e tyre. Jam interesuar, por nuk ka pasur informacion. Natyrisht, edhe këshilli bashkiak ka pasur rolin e tij, të gjithë në unison kanë firmosur dhe i kanë kërkuar edhe kryetarit të bashkisë, presidentit të reagonin. Edhe atë ditë unë kam ndjekur zhvillimet nga zyra ime.

A e prisnit një përshkallëzim të protestës?

Dy ditë pas protestës ka qenë thirrja ime që ne jemi kundër dhunës së çdo lloj personi, individi, institucioni. Unë kam bërë një bashkëbisedim me të gjitha institucionet e shtetit. Kam pasur një bisedë me kryeministrin. Me Presidentin e Republikës, e kam informuar. Ditën e protestës kam komunikuar me drejtorin e policisë së qarkut, ku i kam vënë në dispozicion të gjitha zjarrfikësët, sepse kjo është edhe skema kur ndodh një protestë. Pasi ka ndodhur protesta, normalisht unë nuk kisha informacion që do ndodhte. Ishte vetë këshilli bashkiak që ishte organizator dhe disa qytetarë. Kur kam marrë informacion se ka filluar dhuna, kam tentuar të komunikoja me Drejtorinë Policisë së qarkut, por ishte e pamundur, pastaj më ka telefonuar kryeministri Rama.

Kur ju ka telefonuar, kur filloi përshkallëzimi?

Kur filloi përshkallëzimi, unë isha më shumë i përqendruar për të marrë informacion për jetën e qytetarëve, sepse nuk e kisha informacionin e saktë. Situata siç u pa degradoi shumë shpejt.

Çfarë ju tha kryeministri?

Me kryeministrin biseduam, më tha çfarë po ndodh, i kam thënë unë nuk jam pjesë e kësaj situate, i kam kërkuar zgjidhje që të mos ketë probleme. Është biseduar për një takim ditën e hënë, i kam thënë që jam i gatshëm për këtë takim, për të hënën që kaloi, siç kam qenë gjithmonë.

E takuat?

Nuk e takova, sepse edhe në reagimin që kisha ditën e diel, qytetarët e Kukësit prisnin të kishte një zgjidhje dhe nuk kisha si të shkoja, se qytetarë të Kukësit u arrestuan dhe unë nuk mund të shkoja në këtë takim, ndërkohë që 23 qytetarë të mi ishin të arrestuar.

Në seancën e fundit, zoti Rama u kërkoi falje qytetarëve të Kukësit...

Zoti Rama duhet ta dijë se ka edhe kështilltarë nga Kukësi që atje falja është institucion. Nuk është e lehtë thjesht t'u kërkosh falje. Unë kam kërkuar që institucionet të mbajnë përgjegjësi. Në radhë të parë, zoti Rama duhet të mbante anën e qytetarëve.

Cili është propozimi juaj për taksën?

Ne kemi pasur disa propozime. Propozimi i parë është që të ulemi të bashkëbisedojmë dhe transparenca është kushti kryesor. Dihet që ajo rrugë i tejkalon shpenzimet e veta. Kam pasur propozimin që të mos kishte pikë mes tunelit. Nuk është një zgjidhje edhe nga ana praktike. Kam biseduar edhe me kryetarin e Prishtinës.

REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli, ***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI,
ADMINISTRATA: **Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416, ***Marketingu:*** Cel:0682074415-***email:marketing@gazetashqiptare.com***, **ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116, ***Marketingu:*** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.gsh.al, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**

Qindra qytetarë kundërshtojnë taksën e Rrugës së Kombit

Shoqëria civile në protestë, i vendos Edi Ramës traun para Kryeministrisë

Solidariteti me kuksianët: Nuk jemi dele

Dhjetëra persona janë bashkuar dje në një protestë para Kryeministrisë, ku në shenjë simbolike i vendosën traun për të mos kaluar kryeministrit Edi Rama. Qytetarët i janë përgjigjur kërkesës së shoqërisë civile për të protestuar në mbështetje të 23 kuksianëve të ndaluar për Rrugën e Kombit. Përmes pankartave të tyre, ata i kanë kërkuar kreut të qeverisë heqjen e tarifës së kalimit në Rrugën e Kombit. "Më arrestoni edhe mua", ishte mbishkrimi kryesor në parullat e qytetarëve, në shenjë solidarizimi kundër arrestimit të 23 kuksianëve për dhunën në Rrugën e Kombit. Protesta e shoqërisë civile ka nisur në lulishten e parkut "Rinia". Më pas ajo është zhvendosur para zyrës së kryeministrit Rama, ku protestuesit kanë bërë thirrje që ai të largohet nga qeverisja. Aktivistë të shoqërisë civile, artistë, qytetarë të papunë, studentë dhe pedagogë u shprehen kundër taksave të larta. Mes tyre pati edhe nga ata që e paralajmëruan qeverinë se protesta në Rrugën e Kombit mund të përsëritet para Kryeministrisë.

Me banderola "boll me arrogancë, dhunë dhe koncesione" protesta e shoqërisë civile nisi në orën 12:00 dhe zgjati rreth 3 orë. Ndërkohë, opozita ka paralajmëruar vazhdimin e protestave dhe javën e ardhshme.

"Protesta e sotme, (djeshme) është për të përkrahur dhe për të treguar mbështetjen për atë që ndodhi në Kalimash, për të gjithë ata protestues që vazhdojnë të jenë në qelitë e paraburgimit dhe për t'i dhënë kryeministrit një mesazh shumë të rëndësishëm që nuk mund të vazhdojmë më të qeverisim me arrogancë, me dhunë policore dhe nuk mund të vazhdojë më të japë hapësirat publike, të cilat u përkasin të gjithë qytetarëve shqiptarë me koncesion, me kontrata ligjore afatgjata vetëm një grushti klientësh të tij, të cilët i përdorin këto hapësira për t'u pasuruar, ndërkohë që qytetarët marrin mbrapsht taksa më të larta dhe kërbaç kur ata ankohen", tha aktivisti Besjan Pesha. Një tjetër përfaqësues i shoqërisë civile, Adriatik Lapaj tha se kjo protestë "është një verdikt kundër dhunës, arrogancës, shpërfilljes së qytetarëve, kundër marrjes së vendimeve dhe imponimeve të tyre përmes kërbaçit". Ndërsa një tjetër iu drejtua me fjalët: "Thonë për shqiptarët që janë popull dele, që kanë nevojë për bari, por ajo që ndodhi në Kukës tregoi të kundërtën. Kuksianët treguan se janë popull ujk. Nuk lejojmë më asnjë arrestim, Rama ti nuk e arreston dot të gjithë popullin shqiptar", tha një tjetër protestues. Përfaqësuesit e shoqërisë civile u kanë bërë thirrje qytetarëve që t'u bashkohen protestave për të drejtat e tyre dhe të mos dalin në rrugë vetëm kur i thërrasin partitë politike.

Protesta e djeshme e shoqërisë civile

THIRRJA PËR RAMËN

"Nuk lejojmë më asnjë arrestim, Rama ti nuk e arreston dot të gjithë popullin shqiptar. Rama ka fuqi më shumë se unë sot e se ne, por fuqia e së vërtetës sonë është më e madhe se e kërbaçit të tij", tha dje një nga protestuesit para Kryeministrisë.

OPOZITA

Partitë e opozitës kanë lajmëruar se do të organizojnë një tjetër aksion protestë, me shumë gjasa ditën e martë, pas pushimeve të Pashkës ortodokse. Ende nuk dihet saktësisht se çfarë do të ndodhë, por nga deklaratat e deputetëve bëhet fjalë për një "rrethim" të Kryeministrisë.

Kreu i grupit të PS, në Elbasan për punësimin

Balla: Luli e nisi i pari mosbindjen civile, nuk paguan ujin që prej 2017-ës

Kryetari i grupit parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla mori pjesë në një takim që u zhvillua në Elbasan për të konsultuar me grupet e interesit strategjinë kombëtare të punësimit. Një nismë kjo e grupit parlamentar të PS për rritjen e mëtejshme të punësimit dhe adresimin e tij sipas nevojave të tregut. Në fjalën e tij, Balla u shpreh se ndihma ekonomike është një zgjidhje e përkohshme dhe se ajo nuk të shpëton, por thjesht të zgjat vuajtjen. Balla gjatë fjalës së tij ka ironizuar edhe mosbindjen civile të opozitës, ku tha se kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha nuk paguan faturën e ujit të pijshëm nga shtatori i 2017-ës. "Ky është i pari që e ka filluar 'mosbindjen civile', pastaj po e ndoqi njeri mbrapa, mirë. E sigurt që nuk do ta ndjekë njeri mbrapa", tha Balla. Ndërsa, përsa i përket protestës së organizuar nga opozita, duke bllokuar akset rrugore dhe duke djegur goma, Balla tha: "Do doja ta mbyllja me diçka që më tha përpara se të vinim këtu një sipërmarrës i Elbasanit. Kishim një vit që në Elbasan nuk kishim më tym, sepse ishim mësuar me tymin e plehrave, por Monika me Edmond Spahon na kthyen dje tymin, duke djegur goma në Bradashesh, na kishte marrë malli për tym, sepse kishim 26 vite që hanim tym, por falë Edi Ramës Elbasani është shëruar nga një prej sëmundjeve më të mëdha që ka pasur në gjithë këto vite tranzicioni, shërimi ndaj sëmundjes së tymit të plehrave", deklaroi Balla. Sipas Ballës, për Lulzimin sot koeficienti i lumturisë matet me sa mund t'i bëjë keq Shqipërisë. "Detyra jonë është të vazhdojmë t'i bëjmë mirë Shqipërisë. Edhe pak ditë, pavarësisht tymit të gomave, çizmeve, klithmave, ne do të kemi mundësi që më 17 prill të marrim një lajm të mirë për Shqipërinë, që është rekomandimi i Komisionit Evropian për hapjen e negociatave. Jam shumë i sigurt çizmet, klithmat, gomat, Luli, Saliu, Monika do vazhdojnë të njëjtën këngë, por detyra jonë është të krijojmë sa më shumë punë për shqiptarët, të cilët ende nuk kanë pasur mundësi t'u jepet një vend pune", tha Balla.

Kreu i grupit të LSI-së akuzon Ramën se po fshihet nga protestat

Petrit Vasili: Ky kryeministër e ka hak drurin e popullit

Kreu i grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili u shpreh dje përmes një statusi në "Facebook" se, "kryeministri që demek do qeveriste me popullin i fshihet popullit. Sa turp!". sipas deputetit të LSI-së, "kjo ishte parulla me të cilën përmbyti televizionet, 'Facebook' e 'Twiter' e çdo çmenduri që i doli përpara. Po tani? Shoqëria civile tani është përpara Kryeministrisë dhe kryeministri rri i fshehur vrimave", u shpreh kryetari i grupit parlamentar të LSI-së, duke kritikuar qëndrimin e kreut të qeverisë ndaj protestave të kuksianëve dhe qytetarëve që u solidarizuan me ta kundër taksës së Rrugës së Kombit. "Popullit del në Kukës, kryeministri struket në Vlorë e pastaj u flet me 'Ertv' nga zyra. Popullit përmbytet në Shkodër kryeministri fshihet në Korçë. Populli është në të gjitha rrugët e Shqipërisë, ky zhduket fare nga qarkullimi. Policët e kryeministrit rrëmbejnë popullin e Kukësit natën në gjumë, ky fshihet në studiot e TV e bën sikur flet nga Australia. Kjo ishte qeverisja e falimentuar e kryeministrit me popullin", u shpreh Vasili më tej. "Ky kryeministër që ia tall, ia përçmon, ia përbuz hallin popullit, jo vetëm nuk qeveris dot kurrë më popullin, por e ka hak, bile e ka pak drurin e popullit", theksoi Petrit Vasili. Edhe LSI iu bashkua të enjten aksionit të mosbindjes civile, duke bllokuar rrugët në Tiranë, Elbasan, Kukës, Lezhë e ndërkohë opozita ka lajmëruar një tjetër protestë gjatë kësaj jave.

Kreu i grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili

Ministri flet nga Shkodra, kritikon drejtorët rajonalë të PS

Bushati: Presim rekomandimin e KE më 17 prill, opozita t'i kthehet arsyes

"Nevojitet konsensus i plotë për nisjen e bisedimeve"

Darina Tanushi

Më 17 prill presim që Komisioni Europian të rekomandojë për Shqipërinë çeljen e negociatave për anëtarësim në BE", deklaroi nga Shkodra, kryediplomati Ditmir Bushati. Në një prononcim për mediat, ministri për Europën dhe Punët e Jashtme shprehu besimin që KE do të konfirmojë reformat duke e kthyer 17 prillin, në një moment të rëndësishëm për Shqipërinë, përtej qeverisë e opozitës. "Kemi një ndryshim qëndrimi nga ana e opozitës, por nuk është hera e parë. Shpresoj t'i rikthehen rrugës së arsyes. 17 prilli është një moment i rëndësishëm jo për qeverinë 'Rama', jo për opozitën, por për Shqipërinë. Ne besojmë se meritojmë që Komisioni Europian të propozojë nisjen e bisedimeve për anëtarësim në BE, që do të ishte një sukses për Shqipërinë dhe shqiptarët", nënvizoi Bushati. Ministri tha se, "ne presim që Komisioni Europian në 17 prill të konfirmojë pikërisht reformat që janë bërë në Shqipëri dhe të propozojë nisjen e bisedimeve dhe më pas do të jetë një punë tjetër voluminoze me vendet anëtare të BE, siç dihet nevojitet konsensus i plotë, në mënyrë që të nisë procesi i vështirë, sfidues për anëtarësim që nuk do të jetë aspak një proces i lehtë". Por a rrezikon Shqipëria të mos marrë përgjigjen pozitive dhe sa përgjegjësi ka qeveria. Në këtë pikë Bushati deklaron se nuk i pëlqen të flasë me 'nëse' dhe pas çeljes negociatave, beson se do të nisë puna sfiduese për anëtarësimin e plotë në BE. Bushati i bëri këto deklarata pas një mbledhje mbi 3-orëshe në Partinë Socialiste të Shkodrës në cilësinë e koordinatorit politik të qarkut, ku mësohet se u tregua kritik me drejtorët me disa prej drejtorëve sa i përket shëerbimit ndaj qytetarëve, ashtu siç kërkoi që të nisë puna për fushatën elektorale për zgjedhjet vendore të 2019. Raporti i Progresit që do të publikohet nga Komisioni Evropian më 17 prill, bashkë me vlerësimet për progresin e arritur vjetor do të paraqesë edhe progresin që vendi e ka arritur. Sipas deklaratave të bëra nga presidenti i Komisionit Evropian, Juncker gjatë vizitës së fundit në Tiranë, duket se do të ketë një rekomandim pozitiv për Shqipërinë, por kjo u mbetet në dorë vendeve të Bashkimit Evropian, të cilat do të votojnë në momentin që ky raport të diskutohet në një seancë të veçantë më pas. Gjatë vizitës në Tiranë, Jean Claude Juncker nuk ka dashur të japë premtime "boshe", siç i quajti ai, por la si detyrë zgjidhjet e mosmarrëveshjeve territoriale, duke nënkuptuar një marrëveshje me Greqinë, e cila ende nuk është bërë gati. "Ka të bëjë me problemet që mund të ekzistojnë ndërmjet Shqipërisë dhe Greqisë. Jam i mendimit se ato duhen zgjidhur sa më shpejt të jetë e mundur", tha Juncker.

VENDIMI

Raporti i Progresit që do të publikohet nga Komisioni Evropian më 17 prill, bashkë me vlerësimet për progresin e arritur vjetor do të paraqesë edhe progresin që vendi e ka arritur. Sipas deklaratave të bëra nga presidenti i Komisionit Evropian, Juncker gjatë vizitës së fundit në Tiranë, duket se do të ketë një rekomandim pozitiv për Shqipërinë.

DEKLARATA

"Kemi një ndryshim qëndrimi nga ana e opozitës, por nuk është hera e parë. Shpresoj t'i rikthehen rrugës së arsyes. 17 prilli është një moment i rëndësishëm jo për qeverinë 'Rama', jo për opozitën, por për Shqipërinë. Ne besojmë se meritojmë që Komisioni Europian të propozojë nisjen e bisedimeve për anëtarësim në BE", tha dje Bushati.

Ministrja e Mbrojtjes përkujton dy ushtarakët e rënë në detyrë

Modernizimi i FA, Xhaçka: Edhe Forca Ajrore, në proces reformimi

Në Bazën Ajrore të Farkës është përkujtuar 2-vjetori i rënies në detyrë të dy "Dëshmove të Atdheut", kapiten Florian Deliut dhe toger Donald Hoxhës, të cilët humbën jetën në një aksident ajror gjatë kryerjes së detyrës. Ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka gjatë fjalës së saj në ceremoni bëri me dije se në funksion të rritjes së sigurisë për Forcën Ajrore, ashtu si dhe në forcat e tjera vijon procesi i reformimit dhe i modernizimit. "Ashtu si edhe një pjesë tjetër e ushtrisë, tanimë në NATO edhe arma e aviacionit ndodhet në një proces reformimi dhe modernizimi, për rritjen e performancës dhe kapaciteteve tona në hapësirën ajrore. Specifika e profesionit të ushtarakut është përkushtimi dhe gatishmëria për të sakrifikuar edhe jetën e tyre. Pavarësisht armës ku bëjnë pjesë dhe frontit ku shërbejnë, që në momentin e parë një ushtarak vesh uniformën dhe merr përsipër angazhimin solemn duke qenë i gatshëm për t'i shërbyer atdheut, duke sakrifikuar atë që është më sublime, jetën për kombin, popullin dhe vendin e tij. Ky angazhim solemn i një ushtaraku na detyron të gjithëve të kujtojmë me respekt sakrificën e atyre që jeta iu pre shkurt, iu pre në lule të moshës, por edhe gjithë të tjerëve që i shërbejnë atdheut të përbashkët dhe që kanë marrë përsipër rreziqet që ju cenojnë jetën dhe profesioni i pilotit mbetet një prej tyre. Siguristh trajnimi, taktika, pajisjet përdorimi i elementëve të tjerë që i janë shtuar ose përmirësuar me kalimin e kohës e kanë ulur probabilitetin e aksidenteve", - u shpreh Xhaçka. Më pas, ministrja së bashku me shefin i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjeneral brigade, Bardhyl Kollçakun, drejtuesin e Forcës Ajrore, Kuto Hasanin, si dhe familjarë e të afërm të dëshmorëve vendosën kurora dhe buqeta me lule në memorialin kushtuar pilotëve të rënë në Bazën Ajrore të Farkës. "Dëshmorët e Atdheut", kapiten Florian Delia dhe toger Donald Hoxha ranë në krye të detyrës dy vite më parë, si pasojë e rrëzimit të helikopterit EC -145 në Grizhë të Malësisë së Madhe, gjatë një fluturimi stërvitor, ku mbeti i plagosur edhe ushtari profesionist, Gerald Baramuça.

Reforma zgjedhore, Kuvendi shtyn edhe me 4 muaj punën e komisionit

Kuvendi ka vendosur të shtyjë edhe me katër muaj të tjerë veprimtarinë e Komisionit të Posaçëm për Reformën Zgjedhore. Me një vendim të marrë në seancën e datës 29 mars, deputetët vendosën që "afati i veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Realizimin e Reformës Zgjedhore zgjatet për një periudhë 4-mujore nga data e miratimit të këtij vendimi". Deri më tani ky komision ka bërë disa dëgjesa me aktorë të shoqërisë civile për të thithur prej tyre propozimet për këtë reformë. Nga ana e tij, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka bërë një sërë propozimesh. Bashkëkryetari i Komisionit të Posaçëm të Reformës Zgjedhore, Oerd Bylykbashi u shpreh gjatë mbledhjes së fundit të komisionit se tani kanë marrë asistencë nga ndërkombëtarët që do ta ndihmojnë punën e komisionit. "Ne kemi pasur një mbledhje të përbashkët me përfaqësuesit e OSBE-së, Këshillit të Evropës dhe të Bashkimit Evropian për të diskutuar modalitetet dhe mundësitë e asistencës dhe të ekspertizës për Komisionin e Reformës Zgjedhore. Ndërkohë, kemi çuar shkresa ku kemi kërkuar mbështetjen me ekspertizë dhe asistencë tek OSBE-ODIHR, Komisionin e Venecias, për Prezencën e OSBE-së në Shqipëri dhe Zyrën e Këshillit të Evropës në Shqipëri. Kemi marrë përgjigje pozitive nga të gjithë, në mënyrë të veçantë nga OSBE-ODIHR dhe Komisioni i Venecias për ofrimin e ekspertizës, e cila do të jetë shumë e çmuar në materializimin dhe përfundimin me sukses të gjashtë kolonave të planit të punës që kemi miratuam".

Njoftim i shoqërisë Vodafone Albania Sh.A.

Të nderuar Klientë,

Vodafone Albania ju njofton se duke filluar nga data **16 Prill 2018**:

Paketa e lidhjes **Vodafone Club** me çmim shitjeje **500** Lekë me TVSH do të përmbajë **300** Lekë kredit fillestar të vlefshëm për 12 muaj si dhe **500** SMS drejt rrjetit Vodafone të vlefshme për 14 ditë.

Për më shumë informacion telefononi 140, vizitoni vodafone.al ose dyqanet Vodafone.

Bizneset që hyjnë rishtas në skemën e TVSH-së nuk do të gjobiten për gabimet në deklarim

Ahmetaj urdhëron Tatimet: Mos gjobisni biznesin e vogël

Njësitë tregtare do të "falen" deri në fund të vitit

Ornela Manjani

Ministri i Financave, Arben Ahmetaj ka urdhëruar administratën tatimore të mos gjobisë bizneset e vogla, që hyjnë për herë të parë në skemën e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar. Përmes një shkresë zyrtare, Ahmetaj u ka kërkuar Tatimeve që të ndihmojnë biznesin për deklarimin e TVSH-së dhe të shmangin masat ndëshkuese deri në fund të këtij viti. "Strukturat përgjegjëse në varësi të DPT duhet të asistojnë bizneset për të korrigjuar gabimet në deklarim, duke shmangur gjobat dhe penalitetet deri në fund të vitit 2018", thuhet në letër. Sipas kreut të Financave, do të jetë në përgjegjësi të administratës tatimore të konstatojë çdo deklarim të vonuar apo mosdeklarim të bizneseve që hyjnë në TVSH. "Deri në 15 korrik, që përbën momentin e parë të deklarimit për biznesin e vogël, administrata tatimore duhet të kontaktojë detyrimisht me çdo subjekt që preket nga ndryshimet ligjore, duke asistuar tatimpaguesit të deklarojnë në kohë dhe të shmangin parregullsitë", vijon letra. Nga 1 prilli bizneset me xhiro mbi 2 milionë lekë në janë të detyruara të deklarojnë dhe paguajnë Tatim mbi Vlerën e Shtuar. Sipas qeverisë, qëllimi i kësaj mase është të mbyllë shtigjet e evazionit për biznesin e madh. Por, përfshirja në TVSH ka shkaktuar frikë dhe pasiguri

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
KABINETI

Nr. 6922 prot. Tiranë, më 6.04.2018

Lënda: Për kështillimin e tatimpaguesve subjekte të ndryshimit të kufirit të TVSH

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË TATIMEVE
Adresa: Rruga Gjin Bue Shpata, 1000, Tiranë

Në vijim të fushatës informuese lidhur me ndryshimin e kufirit minimal të regjistrimit për tatimin mbi vlerën e shtuar për subjektet me qarkullim prej 2 000 000 (dy milionë) lekësh, me hyrjen në fuqi të ligjit, shërbimet e tatimpaguesve në administratën tatimore si dhe të gjitha strukturat e tjera që janë në kontakt me tatimpaguesit duhet të angazhohen në një

në radhët e biznesit të vogël. Shumë tregtarë të vegjël ankohen se janë të paqartë dhe nuk kanë njohuritë e duhura për të deklaruar TVSH-në sipas ligjit. Ata u druhen masave ndëshkuese nga Tatimet. Por, sipas Ministrisë së Financave, administrata nuk do të lejohet t'i penalizojë këto biznese deri në fund të vitit.

TRAJNIMET

Rreth 1959 subjekte kanë marrë pjesë në sesionin e trajnimeve të biznesit të vogël, që po zhvillohen në rang vendi që nga data 1 prill 2018. Referuar të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, që nga fillimi i marsit e deri më tani, specialistët e Shërbimit ndaj Tatimpaguesve kanë vizituar 2764 biznese të vogla. Ndërkohë, gjatë kësaj periudhe këndet e asistencës kanë ofruar informacione si dhe kanë orientuar 2367 subjekte. Sipas DPT-së, në total janë trajnuar 7090 subjekte, një shifër e cila përkon me 70% të totalit të tyre që janë njoftuar nga Administrata Tatimore për përfshirjen në skemën e TVSH-së, e cila ka nisur të zbatohet që nga 1 prilli. Sesionet e trajnimeve, që janë 100 në total do të zgjasin deri në fund të muajit qershor.

BIZNESET ME XHIRO VJETORE 2-5 MILIONË LEKË DUHET TË BËJNË:

1- Ndryshimin e shkallës tatimore duke vendosur shkallën 20% apo shkallët e reduktuara sipas fushës së veprimtarisë së tatimpaguesve.
2- Të gjithë tatimpaguesit që janë përfshirë në skemën e TVSH-së kanë të drejtë që në periudhën e parë tatimore (prill 2018), të njohin TVSH-në e zbritshme për mallrat e inventarit gjendje në datën 31 mars 2018, mallra këto me qëllim për t'u shitur për të cilat do të llogaritet TVSH-ja në shitje.

Kushtet që duhet të plotësohen për të ushtruar këtë të drejtë janë si më poshtë:

- Mallrat do të shërbejnë për kryerjen e furnizimeve të tatueshme që kanë të drejtën e zbritjes.
- Të kenë evidentuar listën e mallrave stok (inventarin) të specifikuar në sasi dhe në vlerë. Një kopje e inventarit duhet të dorëzohet në Drejtorinë Rajonale Tatimore dhe të ngarkohet në 'e-Filing', tek rubrika "Çështjet e mia", brenda datës 30 prill 2018. Ky inventar duhet të jetë i evidentuar në regjistrat dhe kontabilitetin e personit të tatueshëm.
- Çdo mall i përfshirë në inventar duhet të jetë i justifikuar me faturë tatimore të blerjes me TVSH dhe i blerë jo më parë së 12 periudha tatimore.
- Të pajisen me blloqe të faturave tatimore pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore ku janë të regjistruar, për rastet kur do të kryejë transaksione me vlerë mbi 40,000 lekë dhe/ose nën këtë vlerë kur e kërkon blerësi. Të lëshojnë kupon tatimor për çdo shitje për klientët konsumatorë finalë.
- Të regjistrojë në mënyrë kronologjike faturat e shitjes dhe të blerjes, në format elektronik, në librat mujorë të shitjes dhe blerjes. Afati i parë i këtij deklarimi është data 10 korrik 2018, për periudhat tatimore prill-maj-qershor 2018.
- Të dorëzojë deklaratën e TVSH-së, bazuar në të dhënat e librave të shitjes dhe të blerjes, e cila përpilohet me bazë mujore dhe dorëzohet elektronikisht brenda datës 14 të muajit pasardhës të tremujorit përkatës. Afati i parë i këtij deklarimi është data 14 korrik 2018, për periudhat prill-maj-qershor 2018.

Kriteret për trajtim financiar të veçantë

Statusi i naftëtarit, miratohen 850 aplikime

Komisioni i posaçëm i ngritur pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë ka shqyrtuar dhe miratuar 850 aplikime të punonjësve të industrisë nxjerrëse të naftës, për marrjen e statusit të veçantë të naftëtarit. Aktualisht komisioni përkatës po vazhdon shqyrtimin e dokumentacionit për aplikimet e tjera. Ndërsa me përparësi janë trajtuar punonjësit e rafinerive të Ballshit dhe Fierit. Ligji i ri nr. 8/2017 "Për statusin e punonjësve të industrisë së naftës dhe të gazit" i miratuar më 02.02.2017 nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka për qëllim të përcaktojë statusin e punonjësve të industrisë së naftës dhe të gazit dhe më specifikisht adreson pozitën juridike, ekonomiko-financiare dhe shoqërore, të drejtat dhe detyrimet që lidhen me këtë punonjës, si edhe garancitë ligjore përkatëse për zbatimin e tyre. Sipas përcaktimeve të ligjit, të drejtën e statusit të punonjësit të naftës/gazit e përfitojnë të gjithë ish-punonjësit dhe punonjësit aktualë, duke filluar që nga data e fillimit të punës në sektorin përkatës. Këtu përfshihen edhe ata persona që janë aksidentuar në punë, pavarësisht kohëzgjatjes së punësimit të tyre. Të gjithë personat që përfitojnë statusin do të pajisen me dëshmi zyrtare identifikimi, sipas kritereve të përcaktuara në VKM. Ligji përcakton gjithashtu kritere për trajtim financiar të posaçëm, të rezervuar për këtë kategori punonjësish në rast papunësie, apo shkëputje të marrëdhënies së punësimit. Punonjësit e industrisë së naftës dhe gazit që gëzojnë statusin e naftëtarit dhe që dalin në pension, ose kanë dalë në pension përfitojnë shtesë pensioni në masën 1% për çdo vit pune, por jo më shumë se 40% të vlerës së pensionit të plotë të pleqërisë, të llogaritur apo aktual, për punonjësit që kanë jo më pak se 30 vjet punë për burrat dhe 25 vjet punë për gratë në industrinë e naftës.

Rregulloja e Bankës së Shqipërisë Si të ndryshoni monedhën e kredisë

Që prej datës 1 qershor, cilido prej konsumatorëve që ka një kredi në monedhë tjetër nga ajo që merr të ardhurat, ka të drejtë të kërkojë ndryshimin e saj në bankën që i ka dhënë huan. Banka e Shqipërisë ka miratuar një rregullore të re, e cila i jep fuqi çdo qytetari që ka kredi konsumatore apo me kolateral, që të kërkojë ndryshimin e monedhës. Në rastin që ke një kredi në euro, por paga mujore është në lekë, atëherë të lind e drejta për të ndryshuar kredinë në monedhën që merr rrogën. E njëjta gjë do të vlejë edhe për kreditë, të cilat janë në dollarë apo në lekë. Banka Qendrore sqaron se kursi i këmbimit për monedhën që do të ndryshohet merret si referencë ai në ditën që kryhet konvertimi i kredisë, ndërsa norma e interesit do të përcaktohet mes palëve që bëjnë ndryshimet në kontratë. "Kursi i këmbimit me të cilin do të realizohet konvertimi i monedhës së kredisë do të jetë kursi zyrtar i bankës në ditën që kryhet konvertimi, nëse nuk përcaktohet ndryshe në kontratë. Ndërsa norma e interesit në këtë rast pas konvertimit, do të përcaktohet si gjithnjë në marrëveshje midis palëve në kontratën e kredisë, ose në ndryshimet apo shtesat e saj". Rregullorja tashmë detyron edhe bankat që të japin informacion ilustrues për klientët të cilët marrin kredi në monedhë të ndryshme nga ajo që kanë të ardhurat. Kjo nismë është pjesë e paketës së deurizimit dhe synon që të ulë stokun e kredisë në euro.

Presidenti i Komitetit Ndërkombëtar në Kërkimin e Drejtësisë: Të merren masa të menjëhershme!

"Tirana rrezikohet nga sulmet terroriste"

Alejo Vidal-Quadras: Regjimi iranian, fushatë që kërcënon muxhahedinët

Anëtarët e rezistencës iraniane (muxhahedinët), të cilët janë nën sigurinë e Shqipërisë janë të rrezikuar, teksa mund të ndodhin sulme terroriste nga regjimi iranian". Kështu është shprehur Alejo Vidal-Quadras, presidenti i Komitetit Ndërkombëtar në Kërkimin e Drejtësisë (ISJ), i cili ka paralajmëruar se regjimi iranian është në mes të një fushate, që rrezikon anëtarët e rezistencës iraniane (MEK) që u zhvendosën në sigurinë e Shqipërisë, pasi u larguan nga kampi në Irak. Anëtarët e opozitës që kanë jetuar në Irak, kanë kaluar vite duke iu nënshtruar sulmeve çnjerëzore dhe eksperimenteve mjekësore. 178 banorë humbën jetën atje. Shumë prej banorëve më në fund u transferuan në mënyrë të sigurt në Shqipëri, ku u pritën ngrohtësisht. Ishte një arritje e madhe kur banorët e fundit u larguan nga Iraku dhe u konsiderua si një sukses i madh humanitar, pas një nisme të fortë që përfshinte një sasi të konsiderueshme të presionit diplomatik. Kjo përfshinte Kombet e Bashkuara, ISJ-në, Senatorët e SHBA-ve dhe kongresmenët, anëtarët e Parlamentit, personalitetet amerikane dhe politikanët evropianë. Vidal-Quadras ka bërë thirrje që të ndërmerren masa të menjëhershme, në mënyrë që fushata e Republikës Islamike kundër disidentëve të anulohet. Ai thekson se regjimi iranian ka vënë në shënjestër grupin kryesor të opozitës, Organizatën Popullore të Muxhahedinëve të Iranit (PMOI ose MEK), për dekada dhe ka vrarë mbi 100,000 aktivistë. Ai gjithashtu tha se vrasjet dhe ekzekutimet e anëtarëve të MEK dhe simpatizantëve janë të shoqëruar nga "një operacion masiv i sulmeve të këqija nga Teherani, agjentët e tij dhe lobistët". Regjimi iranian është në një situatë të dëshpëruar pas protestave të përhapura, që filluan në fund të dhjetorit, në të cilat njerëzit protestuan në mbi 140 qytete në Iran. Njerëzit bënë thirrje për ndryshim të regjimit, sepse e dinë se është shansi i tyre i vetëm i lirisë, demokracisë dhe të drejtave të njeriut. Për të kundërshtuar izolimin në rritje të vendit, regjimi po rrit fushatën e shtypjes dhe tani po synon grupin MEK në Shqipëri. Në fund të marsit, media e Shqipërisë njoftoi se forcat e saj të sigurisë kishin arrestuar dy iranianë, që erdhën për të mbledhur informacione dhe për të spiunuar mbi MEK. Vidal-Quadras paralajmëroi se: "Përvoja e kaluar ka treguar që këto lloj aktivitetesh janë si sinjale për akte terroriste. Dhe për të plotësuar këtë përpjekje, regjimi iranian po përgatit veprime në Parlamentin Evropian, me ndihmën e disa deputetëve proiranian, të synuara për shpërndarjen e gënjeshtrave dhe akuzave kundër opozitës". Ai përmendi se Ministria e Inteligjencës dhe Sigurisë (MOIS) e Iranit ka rekrutuar Massoud Khodabandeh, i lindur në Iran dhe bashkëshorten e tij britanike, Ann Singleton, për të përhapur akuza kundër MEK. Teksa Singleton ka udhëtuar në Shqipëri të paktën tri herë gjatë disa muajve të fundit, ku ajo flet çdo herë kundër MEK-ut. Vidal-Quadras tha se Singleton dhe disa të tjerë do të marrin pjesë në një takim në Parlamentin Europian në ditët e ardhshme (në vijim të aktiviteteve të tyre kundër popullit iranian dhe MEK). Ai shtoi se është thelbësore që autoritetet përkatëse të veprojnë menjëherë, veçanërisht kur ka indikacione nga ngjarjet e kaluara se një sulm terrorist mund të jetë i afërt. Ai theksoi se regjimi nuk po rrezikon vetëm sigurinë e refugjatëve iranianë dhe të anëtarëve të MEK, por Evropës si një e tërë.

MASAT
Vidal-Quadras ka bërë thirrje që të ndërmerren masa të menjëhershme, në mënyrë që fushata e Republikës Islamike kundër disidentëve të anulohet. Ai thekson se regjimi iranian ka vënë në shënjestër grupin kryesor të opozitës, Organizatën Popullore të Muxhahedinëve të Iranit (PMOI ose MEK), për dekada dhe ka vrarë mbi 100,000 aktivistë.

Trafikoi vajzën e mitur si prostitutë në Kosovë, arrestohet tutorja

TROPOJË - Një 57-vjeçare nga Tropoja ka përfunduar në pranga, pasi prej dy vitesh ishte e shpallur në kërkim për "trafikim personash". Burime nga policia bënë me dije se Gjyle Hajdaraj, banuese në Bajram-Curri akuzohet se në bashkëpunim me shtetasin Qazim Gjocaj kanë trafikuar drejt Kosovës një vajzë si prostitutë. Kapja dhe ndalimi i saj u bë, pasi Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda me datë 06.09.2016 ka lenë në fuqi vendimin nr.78, datë 01.06.2016, të Gjykatës së Shkallës Parë për Krimet e Rënda, e cila e ka dënuar atë me 15 vjet burg për veprën penale "Trafikimi i personave'", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë.

"Shteti të hetojë me autoritetet fqinje për gjetjen e tij"

Zhdukja e 32-vjeçarit, familjarët: Morëm një telefonatë të dyshimtë nga Mali i Zi

VLORË - Pak ditë pas zhdukjes së mistershme të Ksandros Imerajt, i cili ishte nisur për në Itali, familjarët e tij kanë marrë një telefonatë të dyshimtë nga Mali i Zi. Pavarësisht kërkimeve të bëra, policia nuk ka mundur të gjejë asnjë gjurmë të të riut, i cili njihet me emrin (Sandro). Të gjendur në një situatë të tillë dhe pas telefonatës së marrë nga vendi fqinj, familjarët kanë nisur vetë kërkimet nga ajri e deti. Këta të fundit thanë dje për "GSH" se janë të bindur se Sandro ka telefonuar autoritetet në Mal të Zi për t'u kërkuar ndihmë. "Kemi pasur një telefonatë anonime nga Mali i Zi. Na njoftuan se i afërmi ynë, Sandros Imeraj ka njoftuar policinë malazeze se ndodhej në det të hapur dhe se kërkonte ndihmë. Autoritetet atje kanë sinjalizuar dhe portin e Durrësit, por nuk kemi asnjë informacion", - u shprehën të shqetësuar familjarët e 32-vjeçarit. Duke qenë se një ditë më parë në Mal të Zi u gjet edhe motori i ujit me të cilin udhëtonte i riu, familjarët apelojnë që autoritetet shqiptare të thellojnë komunikimin me fqinjët malazezë, me qëllim që edhe ata të kërkojnë për të. Motori i ujit u gjet mbrëmjen e së premtes nga familjarët e 32-vjeçarit në Budva të Malit të Zi. Motori ka qenë në largësi prej 10 miljesh nga bregu i Budvës dhe sipas familjarëve, motori ishte gjysmë i mbytur dhe vetëm pjesa e parë ishte mbi ujë. Ndërkaq, familjarët pohuan se nuk kanë informacione se ku do të shkonte i riu dhe çfarë kishte në motorin e ujit.

"Poshtë makinës gjeta një bidon me benzinë"

Shkrumbohet "BMW seria 7", Everest Meçorapaj: Ishim në gjumë kur u zgjuam nga zhurma e flakët

VLORË - Në orët e para të mëngjesit të djeshëm, zhurma dhe flakët kanë zgjuar nga gjumi familjen Meçorapaj, në lagjen "4 Heronjtë" të qytetit të Vlorës, pasi panë të digjej makina luksoze që Everesti, djali i vetëm i familjes kishte blerë prej pak ditësh. Ndërkaq, 27-vjeçari tha për "GSH" se mjetin e kishte blerë falë kursimeve familjare, (kanë një biznes në Vlorë) dhe se nuk i di arsyet e këtij veprimi. Ndërsa pret që policia të zbardhë ngjarjen e të gjejë autorët, i riu tregoi të gjithë skenën që pa në oborr. Ai nuk përjashton mundësinë se djegia e makinës mund të jetë ndonjë mesazh, por nuk di tek kush ta drejtojë gishtin.

Kur e kuptuat që mjeti juaj ishte djegur?

U zgjova rreth orës 03:30 nga flakët dhe tymi, pati edhe zhurma. Dëgjova të përplasej dera e jashtme dhe kur dal, shikoj makinën në flakë. Tentova ta fikja, por ishte e pamundur. Ngjitur me makinën ishte një bidon 5 litrosh me benzinë. Ishim e gjithë familja në gjumë. Ngjarja ndodhi rreth orës 03:30 të ditës së sotme

Makina ishte në pronësinë tuaj?

Makinën kisha vetëm një javë që e kisha blerë, është në pronësi të një italiani, sepse akoma nuk ma kishte kaluar mua.

Ku dyshoni? A keni ju apo familja juaj ndonjë konflikt?

S'kam probleme me njeri as unë, as familja ime ndaj nuk do kujt t'ia vë gishtin.

Mendoni që djegia e makinës është ndonjë mesazh për ju?

Këto janë gjëra që ndodhin, s'kam ç'të bëj, mund edhe të jetë ashtu, por s'di kush është. E përsëris që s'kam konflikte me njeri.

Makina e djegur në Vlorë

Zbulohet kostoja rekord, 407 mln USD për aksin rrugor Tiranë-Elbasan

Korrupsioni, ish-kreu i ARRSH-së kërkon lirinë në Gjykatën e Lartë

Dashamir Gjika: Nuk jam person i rrezikshëm

TIRANË

Ish-kreu i ARRSH-së, Dashamir Gjika, i cili që prej më shumë se një muaji qëndron në qeli për abuzime në ndërtimin e rrugës Tiranë-Elbasan kërkon lirinë. Ai u bë drejtor tri vite pasi nisi ndërtimi i rrugës në fjalë, që sipas parashikimeve do të kushtonte 407 mln USD. Sipas "Report TV", çështja ndaj Xhikës, i cili akuzohet për korrupsion dhe shpërdorim detyre shkon në Gjykatën e Lartë. Avokatët e ish-zyrtarit të 'Rrugëve' kanë dorëzuar rekursin ku kërkojnë ndryshimin e masës së sigurisë "Arrest me burg" dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda më 4 shkurt dhe konfirmuar nga Apeli më 27 shkurt të këtij viti. Rekurs pranë Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë kanë depozituar edhe ish-vartësit e Xhikës. Bëhet fjalë për Albnes Alite dhe Aksel Qorduku. Sipas mbrojtësit të Gjikës, klienti i tij duhet të lihet i lirë, pasi nuk është një person i rrezikshëm dhe nuk mund të prishë asnjë provë. Në argumentet e paraqitura për rekurs nga Xhika janë renditur disa elementë si: "caktimi i tij drejtor disa vite pasi është nënshkruar marrëveshja për ndërtimin e këtij aksi rrugor, ka arsim të lartë jashtë vendit, është një person me integritet, është i padënuar familjarisht, jeton dhe punon në Shqipëri si dhe faktin që ai nuk mund të ndikojë as tek dëshmitarët dhe as tek prishja e provave". Ish-kreu i Autoritetit Shqiptar të Rrugëve u prangos mbrëmjen e 2 shkurtit me akuzën e korrupsionit dhe shpërdorimit të detyrës. Por sa ishte planifikuar kostoja e kësaj rruge për të cilën auditi i Ministrisë së Infrastrukturës në materialin kallëzues shprehet se ka një dëm prej 54 milionë dollarë? Sipas këtij materiali dhe kontratave të depozituara në gjykatë, rezulton se ndërtimi i rrugës Tiranë-Elbasan ishte parashikuar të kushtonte 407 milionë dollarë sipas kontratës së qeverisë shqiptare me bankën islamike në vitin 2011.

Ish-kreu i ARRSH-së, Dashamir Gjika

REKURSI

Avokatët e ish-zyrtarit të 'Rrugëve' kanë dorëzuar rekursin ku kërkojnë ndryshimin e masës së sigurisë "Arrest me burg" dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, më 4 shkurt dhe konfirmuar nga Apeli më 27 shkurt të këtij viti. Rekurs pranë Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë kanë depozituar edhe dy ish-vartësit e Xhikës. Bëhet fjalë për Albnes Alite dhe Aksel Qorduku.

SHKURT

Shpërndante kokainë në tri zona të kryeqytetit, përfundon në pranga 25-vjeçari Emra Dashi

TIRANË - Një 25-vjeçar është arrestuar dje nga policia e Tiranës, pasi i janë gjetur dhe sekuestruar 70 doza kokainë. Bëhet fjalë për shtetasin Emra Dashi, i dënuar më parë për veprën penale "Shfrytëzim prostitucioni". I riu u kap pranë një lokali në Rrugën e Dibrës. "Në bazë informacioneve që dispononte seksioni për hetimin e narkotikëve në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, të marra në rrugë operative, ka rezultuar se ky shtetas kryente aktivitet të kundraligjshëm të shitjes së lëndëve narkotike të forta të llojit kokainë në doza të vogla personave të ndryshëm në zonat e 'Freskut', 'Xhamllikut' dhe 'Porcelanit'. Shtetasit të lartpërmendur, gjatë kontrollit fizik dhe në banesë i janë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale rreth 70 doza lëndë narkotike", thuhet në njoftimin e policisë. Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për veprime të mëtejshme hetimore për veprën penale të "Prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike".

Drejtuesit e automjeteve "garë" në rrugë, arrestohen 6 persona, pezullohen 18 leje drejtimi

TIRANË - Pavarësisht masave të shtuara të Policisë Rrugore për pasandalimin e aksidenteve, sërish disa drejtues mjetesh vijojnë ta përdorin rrugën si "pistë garash". Mbrëmjen e së premtes, policia e Tiranës ka pezullar 18 leje drejtimi dhe ka arrestuar 6 drejtues mjeti, pasi janë kapur në timon në gjendje të dehur. Sakaq, një tjetër automjet tip "Porche Panamera GTS" u konstatua duke bërë garë në shpejtësi dhe pas ndjekjes e ndalimit nga Policia Rrugore në zonën e Saukut, rezultoi se drejtuesi i mjetit me iniciale R.M. ishte nën efektin e alkolit në masën testi i parë 0.34 mg/l, testi i dytë 0.27 mg/l. Teksa policia i ka kërkuar një drejtuesi mjeti të bëjë testin e alkolit, ai dëgjohet të thotë "Nuk kam frymë or burrë". "Do të them unë kur të ndalosh, fryj", dëgjohet të thotë polici. Ndërkaq, blutë sqaruan se u verifikua se në rrugën "Selim Brahja" shtetasit me iniciale R.TH., M.H. dhe T.M. drejtonin mjetet e tyre nën efektin e alkoolit. Ndërsa, në Unazën e Madhe, automjeti tip "Porche Panamera GTS" u konstatua duke bërë garë me shpejtësi dhe pas ndjekjes e ndalimit nga Policia Rrugore në zonën e Saukut, rezultoi se drejtuesi i mjetit me iniciale R.M. ishte nen efektin e alkolit.

bashkëpunimi gjerman DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT Implemented by giz

Programme: Customer and Performance Oriented Drinking Water and Sanitation Services and "EU support Waste water management and treatment services" (EUSWAM)

The *Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit* GmbH (GIZ) is a federal enterprise that supports the German Government in achieving its objectives in the field of international cooperation for sustainable development. The water programme CPWS assists Albania to provide affordable water supply and sewerage services to its population with an orientation at EU standards. The realisation of the EU action "EU support Waste water management and treatment services" (EUSWAM) delegated to GIZ aims at implementing the second component of "IPA 2016 - Support to Water Management" sector programme, which seeks to enhance the implementation of the Na-tional Water Reform and the progress of Albania towards EU water legislation requirements. The specific objective of the EUSWAM Action is to reduce pollution in Adriatic coastal water via strength-ened capacities and operation and maintenance of waste water infrastructure along the coast and in particular in selected municipalities that have benefited from EU support for the development of their waste water management infrastructure.

The EU financed project forms part of the CPWS and focuses on 4 components:

1. Improvement of the performance and performance reporting of selected waste water utili-ties along the coast of Albania
2. Strengthening of the capacity of the new National Agency for Water Supply and Waste Wa-ter (AKUK) with a particular focus on the waste water sub-sector in line with its recently ap-proved enhanced mandate and policies
3. The improvement of the operation and maintenance of existing coastal waste water treatment plants (WWTP)
4. **The build-up of the awareness and participation of the stakeholders of the waste water sector on the importance of (a) advancing the fulfilment of EU water regulatory requirement especially toward the Urban Waste water Treatment Directive (UWWTD) and (b) encouraging that water utilities delivering waste water related services (collection and treatment) are reasonably covering their costs to ensure sustainability of services in line with prevailing government policies in the sector**

For the support of the GIZ programme team and for the increase of communication and visibility of the programme as well as the awareness and participation of stakeholders, the public and clients of Water Utilities in the water sector, particularly waste water (see component 4), GIZ Office Albania is looking for a:

Advisor – awareness

A. Responsibilities

The Advisor is responsible for:

- implementing standards and guidelines for GIZ and EU communication work described in the "Recommendations for communication by GIZ Offices' and the Communication and Visibility Plan EUSWAM
- assuring the quality of articles from the EUSWAM programme (e.g. publications, press conferences, the internet etc.)
Le të jetë kjo paraqitje e vonuar e shënimeve të Qazim M. Onuzit si një nderim për të dhe shokët e tij që shërbyen në Gjandarmërinë shqiptare dhe njëkohësisht bënë qëndresën antifashiste në Prill të '39-s.

Historia vonon, siç ka vepruar shumë herë ndër shqiptarët, por nuk harron.

Dhe ata u futën në histori si njerëz të thjeshtë, të pabujë, që do dëshmonin për historinë, por njëkohësisht do i përkisnin asaj gjithmonë e jetë.

* * *

Qazim M. Onuzi leu në vitin 1907.

Para se të vinte 7 prilli dramatik i '39-s, kishte shërbye në Gjandarmarinë shqiptare në qytete a qytetza të ndryshme (Sipas tij: "Vendet qi kemi shërbye janë kto: Tropojë, Shkodër, Koplik, Kukës, Dibër, Durrës, Berat, Skrapar, Vlonë, Tepelenë, Korçë, Pogradec dhe Bilisht e Pukë, porse në kto Qendra ma të shumtën në Posta").

7 Prilli e gjeti postkomandantin Qazim M. Onuzi në përballje me ushtrinë fashiste italiane.

Në shënime jepet qartë atmosfera e prag-luftës dhe më pas e luftës vetë, por nga ana e forcave të Gjandarmërisë shqiptare, në atë përfshirje, me një organizim deri - diku të shrregullt.

Atmosfera është e rëndë.

→ Vijon në faqen 14

Nisma e jashtëzakonshme në SHBA:
Të vijë biblioteka e profesor Joklit në Shqipëri!
E la vetë amanet tek Profesor Çabej!

Redaktor: Ben Andoni; Grafika Artan Buca 330

Në këtë numër: GJERGJ SINANI, PETRIT PALUSHI, AGRON ALIBALI, ARLINDA CENAJ (POST MORTUM), PETRAQ RISTO ETJ

KUJTIME

Në librin "Dëshmi e rrallë" (7 prill 1939), mbas 79 vjetësh botohen materiale nga "Shënime mbi jetëshkrim" të Qazim M. Ahmetit (Onuzi), prej katundit Nangë (Rrethi Kukës). Ato japin kryesisht atmosferë lufte të 7 prillit dramatik të 1939-s, por dhe një jetëshkrim të pasur të Qazim M. Onuzit kur shërbente në Gjandarmërinë shqiptare para dhe pas kësaj kohe, derisa doli në lirim për arsye shëndetësore më 20 dhjetor të 1939-s. . .Shkrimtari Palushi e ka sjellë për publikun me rastin e Ditës së Pushtimit

Dëshmia e rrallë e 7 prillit të 1939-s, përmes ditarit të postkomandantit Qazim M. Onuzi

NGA PETRIT PALUSHI

(Vijon nga faqja 13)

Informacioni që jepet në këto shënime është i çuditshëm, plot sinqeritet.

Lufta dhe përballja në front shihet nga këndi i një njeriu të thjeshtë, tepër të njerëzishëm, që mundohet të dëshmojë realisht se ç'ndodhi prej fillimit të datës 2 prill, por përqendrohet më tepër në ditën e zezonës të 7 prillit të 1939-s.

Post-komandanti lumjan Qazim Matë Onuzi e dinte detyrën e vet.

Detyra e shenjtë e thirrte me shkue në frontin e betejës pa u shmallë me kënd dhe pa i thënë as lamtumirë kujt.

Se njerëzit e familjes i kishte shumë larg dhe asnjë lajm s'mundi t'u niste. N'asnjë formë, sido ta merrte me mend.

U nis me shokët e vet në front, pa e dijtë mirë se ç'do të sillnin ditët a netët në vijim.

Në front, në Durrës me ba qëndresë kundër Italisë fashiste, pikërisht kundër asaj Italie, ku në Romë (në vitin 1929) kishte ndjekë për tre muaj kursin e karabinierisë.

Tashmë detyra ndaj atdheut tashmë ishte e lartë, sublime, e pandërrueshme me asgjë.

Sipas dëshmisë, "Dhe mbas akshamit, të tri kompanitë që ishna 350 shpirtë si dhe ato të Qarkut (të) Durrësit na shpërndanë nëpër pozicione, dmth., viseve për Qëndresë. Atëherë, vetvetiu u kuptue se konflikti qenka me Italinë, kurse eprorët akoma nuk na jepshin hollsina mbi çeshtjen". Është një rrëfim i një post-komandanti të dëshpëruar (krejt ndryshe nga ç'jemi mësuar të shkruhet përgjithësisht për atë ngjarje, ku rezistenca e qëndrestarëve realë është anashkaluar), të cilin, bashkë me kolegët e tij, eprorët e vendosin në fushën e betejës, por që në mëngjesin e trishtë të 7 Prillit kur "filloi lufta egërsisht", ai sheh një togkomandant që braktis frontin me dy skuadra, duke lënë shumë gjëra në mëshirë të fatit ("… Pra, sa filloi lufta, iku me dy skuadrat, të parën e të tretën, tue na u largue me kta edhe disa gjindarmë të skuadrës t'ime, ku unë, simbas urdhnit që mvesh ushtarakun, mbajta vendin e caktuem"). Më pas, postkomandanti Qazim M. Onuzi, edhe pse i plagosur, lihet në vetmi…

Por nuk harron të shënojë në fletore se ia doli që, para se të shtrohet në spital, atë pak armatim që i kish mbetë ta dorëzojë në Komandën e P, të Gjindarmarisë në Tiranë.

Qazim M. Onuzi

Me 21 prill të 1939-s, udhëtoi me aeroplan dhe qëndroi në shtëpi një muaj me leje.

Mbas do kohe, postkomandanti Qazim M. Onuzi, luftëtari i frontit antifashist të 7 Prillit të 1939-s, do kthehej sërishmi në punën e vet, tek zbatonte urdhnat e Komandës P. të Gjindarmërisë (Në rrethin e Pukës, në Komandën e Kryemadhit. Kërkoi daljen në lirim për arsye shëndetësore, por s'i miratohet kërkesa. Transferohet në detyrën e Post-komandantit të Kabashit të Pukës. Me 20 dhjetor të 1939-s del në lirim mbasi kishte krye 14 vjet punë: Në Tropojë, Shkodër, Koplik, Kukës, Dibër, Durrës, Berat, Skrapar, Vlonë, Tepelenë, Korçë, Pogradec dhe Bilisht e Pukë…)

Kthehet në vendlindje, në katundin e vet, Nangë.

***



Asnjëherë në vitet e pasluftës nuk u pa kontributi i këtij njeriu të thjeshtë.

Kishte shërbye në Gjandarmërinë shqiptare në formën më shembullore për 14 vjet rresht, kishte marrë pjesë gjithashtu në rezistencën e 7 Prillit të 1939-s si antifashist i klasit të parë, u plagos në frontin e qëndresës dhe mu për arsye shëndetësore doli në lirim me 20 Dhjetor të 1939-s…

Një vit e një muaj e shtatë ditë para se të vdiste iu ndërpre edhe pensioni si invalid lufte. (Sipas shënimeve të tij: "Kam marrë pension si invalid lufte deri në fund të vitit 1955")

Asnëherë s'u ankua në jetën e vet për pengesat e vështirësitë.

U rrek ta jetonte jetën ashtu si erdhi, herë të qetë, por më tepër dramatike derisa u nda prej saj në 7 shkurt të 1957-s.

DËSHMIA E QAZIM M. ONUZIT PËR 7 PRILLIN E 1939-s

***

Në Bilisht, me datën 2 Prill 1939, na u njoftue prej eprorëve tonë për rregullimin e veshmbathjes, pse gjoja do të shkojmë në Tiranë me festue dit-lindjen e trashigimtarit të Zogut, "Skënder", mirëpo ndonse edhe eprorët a do të kishin dijeni apo jo mbi çeshtjen që kërcnohesh.

Pushtimi fashist

U nis me shokët e vet në front, pa e dijtë mirë se ç'do të sillnin ditët a netët në vijim.
Në front, në Durrës me ba qëndresë kundër Italisë fashiste, pikërisht kundër asaj Italie, ku në Romë (në vitin 1929) kishte ndjekë për tre muaj kursin e karabinierisë.
Tashmë detyra ndaj atdheut tashmë ishte e lartë, sublime, e pandërrueshme me asgjë.
Sipas dëshmisë, "Dhe mbas akshamit, të tri kompanitë që ishna 350 shpirtë si dhe ato të Qarkut (të) Durrësit na shpërndanë nëpër pozicione, dmth., viseve për Qëndresë. Atëherë, vetvetiu u kuptue se konflikti qenka me Italinë, kurse eprorët akoma nuk na jepshin hollsina mbi çeshtjen".

Kurse, mbas dy ditësh u informuem indirekt se nuk ish për lindjen e Princit, por edhe sepse nuk kishim dijeni, e kshtu me 5 Prill në mesditë, vetë i tetmbëdhjeti, me shpejtësi të jashtëzakonshme në dy automobila na nisën për Korçë, ku u bashkuem me fuqinë e gjithë Qarkut të Korçës; në ora 9 të natës allafrânga u mbushën 10 automobila me gjindarmë dhe na nisën në drejtim të Elbasanit, e në të dalë drita mbrritëm (në) Elbasan ku ish bashkue edhe fuqija e atij Qarku e mbasi na ndanë në kompani, na nisën në 20 automobila në drejtim për Durrës, ku mbrritëm në ora nji mbasdite.

E tue ndejtë në nji shesh pranë ku ishin ma parë shkollat e gjindarmëris, në kohë mbrâmje flutu-ruen në atmosferë përmbi nesh dy skuadra aeroplanësh, por shkakun e tyne se përse nuk na dhanë dijeni eprorët tonë.

Dhe mbas akshamit, të tri kompanitë që ishna 350 shpirtë si dhe ato të Qarkut (të) Durrësit na shpërndanë nëpër pozicione, dmth., viseve për Qëndresë. Atëherë, vetvetiu u kuptue se konflikti qenka me Italinë, kurse eprorët akoma nuk na jepshin hollsina mbi çeshtjen.

Unë isha në kompaninë e tretë dhe togë e tretë dhe se me skuadrën e dytë me zanë vend pranë Agiptit (Depos benzinës) rreth detit ku isha vetë i njimbëdhjeti si dhe skuadra e parë rreth qytetit dhe e treta te Ura e Dajlanit; dhe kshtu po bëjmë vëzhgimet e hapsinës detit, kurse në ora 2 mbasmesnate, u ndigjue qi deti ushtonte tmerrisht pse vijshin flotat italiane, ku vinte tue zmadhue ushtima e detit edhe prej së largu në hapsinën e detit dukeshin dritat e flotave sikur yjt e qiellit, të cilat ishin ma se 25 flota ku dukeshin grykat e topave të tmerrueshëm.

***

Dhe si u afruen në buzë të detit dhe u rreshtuen flotat, në agim të dritës ora 5 e 30 allafrânga të datës 7 prill 1939, filloi lufta egërsisht, mirpo nji toger ushtrije, i cili ish togkomandant, pra sa filloi lufta, iku me dy skuadrat, të parën e të tretën tue na u largue me kta edhe disa gjindarmë të skuadrës t'ime, ku unë, simbas urdhnit që mvesh ushtarakun, mbajta vendin e caktuem pranë Agiptit (Depos benzinës) vetë i gjashti aty ku isha urdhnue.

Si vazhduem për qëndresën má se dy orë, kur po merret Durrsi u bombardue prej flotave italiane tmerrisht aq qi u errësue dhe u mbulue djelli nga tymi i gjyleve. Në ket kohë fatkeqësisht më plasi nji predhë (gjyle) topi afër tue na flakrue katër-pesë metra n'ajër e tue u plagosë lehtë në dy kambët e dorën e djathtë si edhe piklim ftyrës e tronditja gjithë gjymtyrës trupore, qi aty kam mbetë i tronditun ma tepër se 15 minuta, si edhe plumbat e mitralozit vijshin si breshën, po nuk pashë damtim prej ktyne vetëm katër plumba më ranë në kapotë që kisha veshun dhe nji m'i ra pushkës afër rezës bajonetës tue m'i prishë pak drunin. Mbasi u përmenda ku kisha mbetë, pashë shokët qi më ishin largue, u ngrita, mora pushkën dhe u nisa barkas rrethit rrugës dhe i zuna shokët tek Posta e Dajlanit, aty pak sa me pushue ju mbështetëm Postës e menjiherë na i ranë Postës me top dhe e shkatrroi krejt. Qi aty m'u plagos pak edhe nji gjindarm tue i ra nji copë gjyle në kambën e djathtë; edhe kshtu posa u përhap tymi i gjyles qi shkatrroi Postën, menjiherë vrapuem dhe ju mbështetëm ballit të Urës Dajlanit dhe tue na pa qi ishim mbas

Individi shqiptar, Aushvici... Tepelena, dhuna verbale

NGA BEN ANDONI

Në të gjithë debatet që bëhen në vend, lexuesi, shikuesi dhe dëgjuesi kanë perceptimin se jetojmë në dy Shqipëri. Në atë njërën e perceptuar nga të mirët dhe tjetrën të përvijuar nga të këqijtë. Për një fakt të njëjtë dhe gati kategorik, siç mund të jetë dokumenti real, ka interpretime të ndryshme që në fund të debateve shterpë i humbasin kuptimin vetë domethënies së faktit.

Aq shumë përflitet dokumenti dhe relativizohet çdo gjë, saqë dhuna verbale që ushtrojnë debatuesit të bën *të harrosh* vuajtjen dhe tmerrin dhe të bësh protagonizmin. A ka rëndësi se vdiqën 5. 10, 20 apo 30 fëmijë, apo 300 syresh? Jo është Aushvic. Nuk është Aushvic. A duhet t'i gjejë dikush varret e tyre? Kush i vrau? Pse u detyruan të vdisnin?

Shqipëria ka një specifikë interesante sepse çdo organizim shtetar që ka përfaqësuar sistemin ekonomiko-shoqëror i është kundërvënë ashpër dhe pa kushte paraardhësit. Sistemi monarkik nuk i fali paraardhësit, kurse arriti që të izolojë deri me litar çdo sens republikan në vend. Sistemi komunist shkoi më tej: E filloi shkrimin e historisë pas vitit 1944 dhe gjithçka të bërë deri më atëherë e nxiu në mënyrën më bajate. Për të ardhur në vitin 1990, kur të ashtuquajturit demokratë dhe socialistë, si derivate të vërteta të PPSH-së, jo vetëm mohuan gjithçka të bërë para këtyre kohëve, por u përpoqën të ngrenë një realitet tjetër. Maskimi u krye mrekullisht.

Brenda ligjërimit politik të ashtuquajtur demokratik, janë sajuar dy grupime, që atakojnë gjithçka që bëhet nga tjetri. Kështu individi shqiptar humbet në një qerthull, që mbushet me lloj-lloj simbolikash, së fundmi për interesa të ngritjes së historisë së persekutimit.

Por, po bëhet kaq e shëmtuar kjo, sa përpjekja për të sjellë në mëndjen e publikut kujtesën e diktaturës ka reflektuar nulitetin total ndaj qasjes së problematikës. Dosjet e hapura, deri më tani, thjesht kanë treguar gjëra të stërpara dhe të stërdëgjuara megjithë zhurmën e shumë individëve për t'u evidentuar. Ndërkohë, në këtë angazhim sot e kësaj dite nuk është bërë gjë me të zhdukurit, ashtu si nuk dihen për

shumë nga gjërat që lidhen me të pushkatuarit etj. Derivatet e PPSH-së nuk mund të shkonin më shumë se kaq edhe në parashimin më të mirë.

Pasojat e kësaj tollovie është sot fakti sesi identifikohen simbolet e keqes në vend. Kohë më parë, tifozët e ekipit sportiv të Tiranës për të shprehur armiqësinë me tifozët kundërshtarë të "Partizanit" do të shkruanin një një banderolë të madhe: *"Juve jeni për në Aushvic"*. Pa marrë parasysh faktin që ky episod kaloi pothuaj pa asnjë telash për tifozerinë, ajo zbuloi mentalitetin sesi përshkruhet dhe si identifikohet tmerri i këtij simboli në Shqipëri. Mbi të gjitha si evidentohet tjetri, madje edhe kur ai është një njësoj ose pjesë e një areali.

...

Në kohën e tij, Hitleri, njeriu që ndryshoi për keq fatin e Botës në dekadat e para të shekullit XX, shprehej: *Dy botë përballen me njëri-tjetrin - njerëzit e Perëndisë dhe njerëzit e Satanait! Hebreu është anti-njeri, krijesa e një Zoti tjetër. Duhet të ketë ardhur nga një rrënjë tjetër e racës njerëzore....Të dy rrënjët janë aq të ndara saç është vetë njeriu dhe kafshët. Jo se unë do ta quaja hebreun një kafshë. Ai është shumë më larg edhe nga vetë kafshët. Ai është një krijesë jashtë dhe krejt i huaj edhe për natyrën"*. Fjalë lunatike, por atëkohë të denja për të ndryshuar fatet e botës dhe për të ngritur një popull të tërë pas një ideologjie racash.

Duket se sfida e kujtesës në vendin tonë është mirëfilli antropologjike dhe kurdo në Shqipëri, qoftë në Demokraci, ekziston gati një ndarje antropologjike: Ata dhe Ne. Për fat të keq nga një i njëjti brum. Komunistët bënë të njëjtën gjë, kur vunë në funksion të gjithë artin dhe letërsinë për të përshkruar se ata (lexo: klasat e përmbysura prej tij ishin me probleme!) ishin krejt ndryshe, nuk ishin si të zgjedhurit. Për Arendt-in, një nga kritiket më të thella të nazizmit, theksohej se regjimi totalitar ka shkatërruar mundësinë e veprimit politik, duke i privuar viktimat e saj nga statusi antropologjik i qenieve njerëzore, fakt që përbën veçantinë e tmerrshme të Holokaustit. Dhe, aq e theksuar ishte kjo, saqë esencën e Holokaustit nuk e vë askush në numrin e viktimave, madje edhe në përdorimin e teknologjisë apo dhe burokracinë për ta zbatuar atë, por në sulmin e saj antropologjik, *'duke i bërë qeniet njerëzore të dukeshin si qenie njerëzore janë të tepërta '*, citojmë Arendt.

Larg debateve që po bëhen, por në vëmendjen e njerëzve, nuk duhet të jetë thjesht numri, por mënyra sesi njerëzit e pambrojtur, gratë dhe fëmijët u zhveshën nga koncepti i njeriut. Por, dhuna verbale që ushtrohet nuk e lejon këtë. Lufta e sotme në Shqipëri duket në faktin sesi dhe cili grup mund ta rrëmbejë Aushvicin, ta bëjë të vetin, pa harruar se krejt e jona është simbolika e "Tepelenës" dhe tmerri i saj, që është njësoj i tmerrshëm sa i përket individit shqiptar...me çdo fenomen dhune. Por, dhuna verbale nuk e lejon këtë, ajo do evidentimin e pak njerëzve në kurriz të çdo gjëje. Jemi Ne. Janë Ata.

---

ksaj na i ranë 6 herë me top urës tue i këputë nji kambë çimentoje. Edhe ktu si u përhap tymi me shum mundim kemi kalue urën e hymë majtas fushës tue ndjekë viset e buta qi të moskërcasin gjylet, dhe me qëllim të mos na bombardojshin aeroplanët qi na kishin mbulue përsipër ma se dyqind si edhe plumbat vijshin si breshni.

Shokët kaluen Rrashbullin, unë u ndalova në ecje pse zunë me m'u ftohë plagët si dhe më kapi etja. Kshtu, tue u përpjekë me ecë nga pak më panë dhe shtinë edhe katër herë me top, unë rashë barkas afër nji ligate (kënetë) e tri gjyle më kaluen mi krye, e katërta plasi në afërsi përpara edhe më mbuloi gati krejt me dhè tue ma shtypë gjithë trupin.

Si dola te Posta e Rrashbullit aty gjeta nji gjindarm qi m'priste, bashkë me ket hymë në Postë e pimë ujë, e kur duelëm në derë desh na zuni Posta ndër tà, sepse e shkatrruen me top nga deti.

Shkuem deri në nji farë vendi djathtas, pranë rrugës në fushë janë do baraka ushtarake e disa ushtarë hipshin në nji automobil, por me kto edhe na deri në Rreth-Komandën e Shijakut. Aty gjetëm Rreth-komandantin me dy gjindarmë. Mora bukë edhe 158 fishekë mbasi më ishin mbarue në vijë të luftës, prej 200 copë më kishin mbetë vetëm 36 e bashkë me rreth-komandantin dhe gjindarmët u nisëm në të djathtë të Shijakut e hymë në mal në nji ullishtë se gjoja (të) vijshim nga Tirana. Mirpo, mbasi ndejtëm aty ma se dy orë unë u ligshtova tepër edhe ata u larguen e më lanë vetëm. Edhe unë mbas pak kohe u nisa zhagas dhe rashë në rrugën e madhe, aty mbeta krejt, s'mund eca, por ma vonë erdhi maqina e spitalit ushtarak të Tiranës për të marrë të plagosunit. Më gjetën në rrugë dhe më vunë në maqinë, më dërguen në Tiranë, e dorzova armatimin në Komandën e P. Gjindarmarisë dhe më shtruen në spital, ora 3 mbasdite, të datës 7 prill.

Me 20, po prill, dola nga spitali, qi me 21 (i) hipa aeroplanit dhe erdha në shtëpi me nji muej leje shëndetsije...



Faksimile të ditarit të Qazim Honuzit

Zbarkimi i trupave italiane në Durrës

SHËNIME TË TJERA

42.
Me 1 Nantuer 1935 na u plotësue rroga me gradën Tetar.

43.
Komanda e P. gjindarmëris me urdhnin Nr. 5149/datë 7. 1. 1935, për arësye shëndetësore na transferoi nga Vlona në Qarkun e Korçës Post-komandant i Pleshishtit të rrethit Pogradecit, ku me 17 Dhjetuer mora Postën në dorzim.

44.
Me 30 Maj 1936, ditën e shtunë vdiq kushrini i parë Cen Sadiku nga nji smundje qi vuejti mbrenda javës si tifo.

45.
Komanda e Qarkut Korçës me shkresën Nr. 5 -20/1, dt. 6. 2. 1937 nga Pleshishti na transferoj Post-komandant i Çërravës, rrrethi i Pogradecit dhe me 2 Mars mora Postën në dorzim.

46.
Me datën 16 Maj 1937 u shpall Kryengritja e Delvinës, e cila u kryesonte prej ish-Ministrit të Mbrendshëm në Shqipni, Et'hem Tota nga Progonati i Kurveleshit, qi u vra bashkë me dy vllaznit e tij.

47.
Me urdhnin Nr. 1254, i datës 10. 6. 1937/1 të Komandës P. gjindarmëris, me 1 Qershuer na u plotësue rroga në gradën Rreshter.

48.
Për arsyna shëndetësore nga Posta e Çeravës kërkova transferim dhe me 22 Korrik 1937 na transferuen në Postën e Qendrës Pogradec, ku për disa kohë zavendësova P. e Qendrës.

49.
Me 8 Shtatuer 1937 shkova me transferim Post - komandant, në Velçan - Mokër (Rrethi i Pogradecit)
Me 24 Tetuer 1937, ditën e djelë u martova me nusen e dytë.

50.
Komanda e P. gjindarmëris me urdhnin Nr. 1580/2, datë 21. 6. 1938 nga Posta Velçan (e Mokrës) na transferoj në Sekretarinë e rrethit Bilishtit po të Qarkut Korçës.

52.
Me datën 10 Shtatuer 1938 kemi fejue (zanë) nusen e Hamdiut në katundin Brrut.

53.
Komanda e P. gjindarmaris me urdhnin Nr. 499/I, datë 6/5/1939, nga rrethi i Bilishtit Korçës na transferoj në Rrethin e Pukës, me shërbim ndihmës i Postës Sakatit.

54.
Me 4 Korrik 1939, nga Sakati shkova në Roje Komandën e Kryemadhit.

55.
Me 8 Gusht 1939, me nji lutje kërkova daljen në lirim për arsyna shëndetsore sepse me urdhnin Nr. 110/60, dt. 11-7-1939, i Komandës Rrethit Pukës na u kërkue ri-qëndresa dhe për 5 vjet shërbim e kshtu tue e pa dobsin e trupit nuk e përsërita mâ ri-qëndresën, por kërkova daljen në lirim.

56.
Me urdhnin Nr. 391/31, dt. 18-10-1939 të Komandës Rrethit Pukës, Roje Komanda e Kryemadhit u suprimue, unë u transferova Post-komandant i Kabashit Pukës.

57.
Në bazë t'urdhnit Komandës Qarkut
Shkodrës Nr. 189/88, datë 3-12-1939, njoftue me të Komandës Rrethit Pukës Nr. 334/11, datë 5-12-1939, me 20 Dhjetuer dola në lirim, qi gjithë koha e shërbimit kemi plotësue katërmbëdhjet vjet.

58.
Vendet qi kemi shërbye jan(ë) kto: Tropojë, Shkodër, Koplik, Kukës, Dibër, Durrës, Berat, Skrapar, Vlonë, Tepelenë, Korçë, Pogradec dhe Bilisht e Pukë, porse në kto Qendra ma të shumtën në Posta.

Shkrimtar dhe studiues

POEZIA

Autori shquhet për një ndjeshmëri të lartë poetike dhe stil të mirë, që vjen jo thjesht pas vitesh të tëra pune, por edhe pas shumë sfidash letrare…

Njëmijë zogj argjendi pikëllojnë…

NGA PETRAQ RISTO

Tek e shkuara…

Vizitova të shkuarën: e kisha lënë të re, m'u shfaq e rrënuar
"Mirëmbrëma", i them. Ajo më pyet: Mos jeni vjedhës?...
-Jo, i them, kam ardhur të shoh oborrin…
-Oborrit ia vodhën kumbullën e kuqe
E bëmë dru zjarri për dimrin e egër
O Zot, dhe flakët i kish cipëza kumbullash të pjekur...
Mos kini ardhur për të vjedhur?...
-Oh, jo, erdha të shoh pusin në oborr
-E mbyllëm. Ishte si një sy i keq
Vajzat e lodhura këtu donin të mbyteshin
Ngaqë qielli valëvitet edhe poshtë.
...Po ç'mund të vidhni në këtë shtëpi të vjetër?
Dyert i morën vjeshtën që shkoi: i duhen Parajsës, më thanë
Dritaret m'i morën se u duheshin mëngjeseve të përplasen zogjtë.
...Nëse s'ke ardhur të vjedhësh dhe je Vdekja: më merr
Më ço te kumbulla e kuqe, te pusi i vajzave me sy nga qielli
Te dyert dhe dritaret e mia... kam ëndërruar Parajsën këtu në Ferr.

Ajnshtajni i shkruan Presidentit…

"Mos e përdorni, do shkatërrohet bota…"
Presidenti lexonte: dyshimi i qe ngrirë si trupi mbi rrota

Jashtë Ëashingtonit ishte butë,
Matanë lulëzonin qershitë e Japonisë
Me lule që s'ktheheshin dot në frut.

Thjesht një letër
Mbetur në tryezën e presidentit tjetër
Qershitë japoneze lulëzonin: të bardha si mjegull

… Do shkojmë në një planet tjetër nesër
Do kthejmë kokat pas të shohim Tokën
Me mallin kur shohim varrezën…

S'do jenë as qershitë që sollën në Ëashington… japonezët.

Pas shkatërrimit të Hiroshimës

Njëzetë ditë pas shkatërrimit të Hiroshimës mes hirit atomik çelën lulet e para
Lule të çuditshme me sy, veshë, buzë,
me zemra që regëtinin nga rrënja në aromë
Lule të vockëla: klithma të mbytura, lutje të imta ndaj një Zoti
që s'guxonte të shfaqej
Lule pa ngjyra, me aroma mbytëse si mallkimi.

Njëqind ditë pas shkatërrimit të Hiroshimës ra dëbora e parë:
kimono mëndafshi e shkrirë
mbi një trup
ku s'ekzistonte lakuriqësia.

Dyqind ditë pas shkatërrimit të Hiroshimës pemët lidhën fryte të hidhura
Me bekimin e shkencëtarve dhe urdhrin e qeverisë frytet u hodhën
ngaqë rënkonin
dhe hiroshimasit nuk donin ta shijonin vdekjen e vet.

Lot në brum

E pashë atë grua bukë duke gatuar
Me grushtet e vegjël ngjeshte brumin e bardhë
Llërë përveshur (ah, llërët e saj: ç' brum i ardhur!)
E pashë atë grua gatuante duke qarë.

Ç'bukë e ngrohtë në tryezën e shtruar
Fëmijët rrotull nuk e shijuan kafshatën e parë.
Se ç'ka një shije, tha i pari, bukë e hidhur, o ma...
Mbase soda, mbase mielli, mbase pjekja në zjarr
Dhe pak e kripur, tha e dyta, e kripur, o ma...
E treta klithi nga gëzimi: Gjeta një margaritar!...

Varrmihësi veçmas Shekspirit:

Kafka e Jorikut: tragjedi me shtatë orë (*Kurdiset në fillim të çdo skene*).
I lodhur jam dhe unë: paqe e sapofirmosur nga dora e armikut
Paqe me furtunë. (*Të gjitha paqet kthehen në skelete*).

Kjo varrezë: dorashkë duelesh e harruar nën qiell
Veç krimbat më japin të njohur, s'më quajnë personazh.
Varros kufoma, zhvarros skelete: ushtarë e mbretër - të njëjtin imazh.

Mbretërit peshojnë pak ngaqë varrosen pa kurorën...
Si shenjë u mbetet gjak në skeletin e dorës.

Varrosa Pollonin, rëndonte shumë (*mbase nga dhembja e Ofelisë*)
Varrosa Mbretin Lir me zemërimin – shkrumb të pasurisë...
(*në varr gabimisht kisha mbyllur dhe një qiell stuhish*)

Mbulova Zhuljetën pas një loje me helmin
Dhe Romeon e lidhur me dashurinë si syri me lotin
Me dhé të ftohtë mbulova bijtë dhe etërit
(*Vdekjet kanë forma të ndryshme, të njëjtën formë ka arkivoli*)

Skeletet e të vdekurve me fill marionetash cinizmi i lëviz...
Eshtra personazhesh që mishin e mposhtin...

Mbretërit peshojnë pak: pa kurorë e pa skeptër... i varrosim.

Shekspiri dhe shekulli aventurier

Na paska dalë një Ofeli tjetër
gjithashtu lahet nën shelg
po në vend të saj mbytet shelgu.
Veç Hamletit të saj
nuk do Hamlet tjetër.

Na paska dalë një Desdemonë tjetër
shikon si shtegtojnë lejlekët:
I duken në rresht - shami të bardha
nderë në qiell
me kapse sqepash të verdhë.
Desdemona – monogame si lejlekët.

Re e zezë Otello
pret gryken e vet
gjak rrufeje derdh.

Paska dalë dhe Zhuljeta e dytë
Po ndryshe nga e para
kërkon Romeo të tjerë:
kështu ndodh me mjegullat
kur harbojnë mbi shkëmbinjtë
në humnerë.

Pikëlluar tund kokën Shekspiri:
ç'shekull aventurier!

Një pikë (.)

Ishte një pikë e thjeshtë . si të gjitha pikat
si shenja që lë kompasi mbi letrën e bardhë
para se dikush të krijoj Botën.
Një pikë e vockël në kërkim të mbylljes së një fjalie
mbase të harruar nga Shekspiri...
Një pikë shumë e vockël: majëz nga bari i përjetësisë
rrëmbyer nga gjarpëri i Gilgameshit...
Një pikë thuajse e padukshme: njollëz loti zvogëluar me lupë ligësie.
Rrotull asaj pike u mblodhën të gjithë
të mëdhenj e të vegjël
shikonin njeri - tjetrin në sy
për të zbuluar
nga cila retinë
kish rënë.

Zakone milingonash, bletësh dhe poetësh...

Poetët janë të shumtë, të ngjashëm si mizat e dheut
Të ngjashme dhe kokrrat e grurit që mbajnë mbi vete
Ecin në rresht pas njeri tjetrit me hierarkinë e gënjeshtërt
Të ngjashëm si milingonat: poetët.

Ca milingona nxjerrin krahë dhe martohen në ajër
Pas martesës i këpusin fletët.
Mbretëreshat jetojnë 100 herë më shumë se të tjerët.
Të ngjashëm me milingonat: poetët.

Duke u çiftosur në ajër
Duke ëndërruar hapësirë më tepër
Shumë milingona i ruajtën flatrat: u kthyen në bletë.

Të ngjashme bletët me njëra-tjetrën
Të ngjashme lulet, hojet gjashtë cepësh
Dhe shija e mjaltit: e njëjtë...
Për të mos qenë kaq të barabarta
Zgjodhën Mbretëreshën...

Dhe pse rrallë kjo ndodh me poetët.

Bletët virgjëresha po në ajër martohen me mashkullin mbret
Shpesh pas çiftëzimit femra mbretin vret
Te lulet pa seks zbraz stresin e vet...

Kështu ndodh shpesh dhe me poetët.

Një grua prej shiu…

Takova një grua prej shiu e sapoavulluar nga gjoksi i një burri
Aromën e saj kish bari që mbiu, stuhinë e tij kish afshi që pruri
Një grua prej shiu e tejdukshme prej nurit.
Një grua prej shiu: flokët, gjymtyrët, gishtërinjtë, shikimi…
Prej shiu zemra dhe ëndrrat prej shiu
Unë isha thjesht: ylber i prerë me pamje njeriu.
I lindur nga shiu.

Shkruar në mur...

Kur të gjesh librin e vjetër shkruar në mur
Mos harro të shohësh dhe anën tjetër të murit
Të njëjtin libër ta lexosh në këndvështrim tjetër
Dhe të kuptosh pse muri nuk rrëzohet.
Pastaj mund të mbështetesh në mur
T'ia përcjellësh natyrshëm rrahjet e zemrës
Dhe fjalët e rënda të shkruara në gur
Në forma dritaresh t'i gdhendësh...
Kështu mund ta lexojnë murin dhe të tjerët.

Duke pritur

Një pasqyrë e shkrirë u kthye në det
Një ëndërr: në anije
Molla e kuqe në tryezë: në bovë u kthye.
Vetëm ti mungoje, nuk po vije.

Bromuri i argjendit krijoi ca pulëbardha
Dhe krahët e pulëbardhave e krijuan erën
Lëviza mollën që të zgjohej dallga
Po ti prapë nuk erdhe.

Padashur, padashur pasqyra u thye
Anija u mund nga shtërngata
Molla e kuqe në plagë u kthye
Veç brumuri i argjendit mbeti te pulëbardhat.

…Dhe ti prapë nuk erdhe.

Varka e lodhur

Jam një varkë e lodhur
në kryqin e direkut mbaj gozhduar muzgun
deti përpiqet të më josh në bash
e të më ndez në kiç
duke imituar njerëzit e dashuruar.
Varkë e lodhur jam
mbi një det të trazuar.
Njohje të vjetër me mua
kanë shiu, era, dielli dhe jodi
Velat e mia: gjinj nudoje
hutojnë horizontin.
Jam varkë e lodhur
nga që dashurohem në mëngjes
kur fuzhnjet e diellit ngulen në thellësi
në trupin e një peshkaqeni të padukshëm
tradhtuar nga gjaku mbi dallgë.

Poetët

Me kërcejtë e grunajës
bënim pipëza muzike
dhe dehnim Diellin.

Me Arushën e Madhe
luanim bilardo
dhe yjet binin
në gropën e censurës.

Kush e fitoi lojën?...

Nervozizëm

Ndonjëherë lëviz duart në ajër, gërvisht qiellin me plagë pëllumbash
Shumica mendojnë: flas me vete në përpjekjet për të fluturuar.
Ajri nga joshja më bëhet mollë në duar.

Ndonjëherë bërtas buzë oqeanit, albatrosë e pulëbardha për të hutuar
Po ato s'e njohin mallin e shtegtarit, u duket britma ime
Sirena SOS e anijes mbi shpirtin e trazuar.

Kthehem në shtëpi me një thërrime loti në sy
Me një mollë ajri në duar.

***

Ndonjëherë zhvishem për ti treguar yjeve hartën e lëkurës
Çdo yll zgjedh një nishan dhe nuk gabon
I vetmi që gabon është ylli i fundit: ai ma merr zemrën për nishan.

***

Dhe njeriu është klepsidër:
kur grimcat e rërës shkojnë poshtë,
dheu bie sipër...

***

Oqeani s'mund të quhet plagjiat i qiellit
Përderisa brigjeve shpërndan yje deti.

***

Në spitalin fushor të luftës: mullaga gjaku
Një gramafon i vjetër vërtit plagën e tij
Rreth boshtit të Tokës.

Pasqyra...

1.
Ishe kaq e bukur!
Kam harruar pasqyrën - më the.
Duke u parë në sytë e mi: krehe flokët dhe ike pa kthim...
Kaluan kaq vjet me krehërin tënd në retinë.

2.
Sa herë të mendoj te pasqya e madhe çelet një driatre
Dhe vjen një aromë e njohur borziloku.
Ti përkulesh pak aq sa mund të lejoj pasqyra....

Njëmijë zogj argjendi pikëllojnë.

Sa herë të mendoj kaloj krehërin mbi shi
Askush s'ka flokë argjendi si ti.

Njëmijë zogj argjendi pikëllojnë, njëmijë.

Trëndafili i kuq që dikur kish qenë njeri

Ky trëndafil i kuq në varrezën e vjetër
para dyqind vjetësh qe njeri...
përpiqet i gjori të zgjoj kujtesën nën shi:
kam qenë ushtar
ushtar i vrarë
ndaj u bëra petalekuq
se po të kisha flamur të bardhë
trëndafil i bardhë do isha unë.

Dimër...

Gjethe të ngjashme me astaret e xhepave, të shpuara si xhepat
Pantallonat e trungjeve dridhen: pijanecë në dëshpërim
Ndonjë cicërimë zogu tingëllon si monedha
E sytë e pijanecit ndizen në shkëlqim...

Duke parë një hekur të vjetër për hekurosje në pazarin e Krujës

Antikuari e ktheu në anije...
Nëna: fokiste me një mashë
mbush anijen e vockël me prush
dy lugë të argjendta kafeje i bëri flugerë
nga dera e kuzhinës fryu Trëndafili i Erërave
u gufuan velat: shamitë e nënave të emigrantëve
me lotët ngrirë në formë stërkalash
Anija-antikuar kalon mes ishujve: filxhanë kafeje me harta llumi
plakat rrijnë rrotull: presin kthimin e djemve të vdekur
hekurosin për të njëmijtën herë bluzet e pantallonat e tyre
e nuk shohin si u shtohen rrudhat e fytyrave.
Një e qarë bëhet sirenë, brigjet dridhen:
- Kujdes, moj korbë,
në astaret e xhepave
paska mbetur një monedhë!

Braktisje 1

Shtëpia ka mbetur po ajo veç orenditë kanë pluhur.
Tavani ënderron sikur është qiell dhe s'i duhen muret vertikalë
Qiejt kanë frikë nga muret.
Pse zemra ka formën e gjësë që pikon?
Shtëpia bosh pa frymë. Hijet janë tjerrur në fije merimange
Dhe ti je një flutur që s'mund t'u besosh. Dhe zemra pikon.
Kujtesa është labirint në këputje. Mplakur orenditë.
Të vizatosh në pluhur ç'art i mundimshëm: pluhuri s'ka shpirt.
Gjithçka fle si yjësia në teleskopin e Galileut.
Qiejt kanë frikë nga muret. Dhe zemra pikon e pikon.

TREGIM

Po botojmë një tregim të bërë nga gazetarja, që nuk jeton më. Një teknikë e thjeshtë rrëfimi, por që shpreh dhe shumë nga shqetësimet e mëdha që e ndjera mbarte në vetvete...

Festa e divorcit

NGA ARLINDA CANAJ

Takat e tyre pllaqu riteshin në një nga rrugicat e Bllokut ndërsa tegelat e shiut që binin në asfaltin më shik të kryeqytetit ngjanin me sumbulla të argjenda.

-Ç'na ka gjetur në këtë Shqipëri! Soj-soj gjërash do dëgjojmë! Kjo e fundit nuk më kish shkuar kurrë nëpër mendje!

-Mua nuk më bëri dhe aq shumë përshtypje! -iu gjegj Sonja koleges. -Ka shumë familje që t'i kundrosh nga jashtë duken si ikona virtytesh, po aty nuk është e qëndisur dashuria dhe as katër stinët e Botiçellit. Lulëzojnë vetëm interesat materiale.

-Gratë në kohën e sotme llastohen shumë. Mua kështu më duket!

-Ti i mat gjërat me kutin tënd sepse ndjehesh rehat dhe je një grua me fat. Vuajtjet shpirtërore janë më të mëdha se ato materialet. Ato gërryejnë si një minierë që kurrë nuk pasuron shpirtin.

-Unë po iki! Mirupafshim. Ftesën po ta jap ty. Ta kam falur!

Dhe i nxori një ftesë të kuqe ku ishte vizatuar një trëndafil.

.....

Ndërsa dielli lodron mbi dritaren e dhomës, Sonja ulur në poltronë përballë pasqyrës së komosë kundron rrudhat që kishin nisur të shtoheshin. Ndoshta nga e enjtja e javës tjetër i duhet të bënte një seancë tjetër botoksi. Lëkura i ishte ashpërsuar dhe pse e trajtonte me kremra të shtrenjtë. Vetullat ishin lënuar mbi tëmtha dhe buzët ishin kreshpëzuar. Rrudhi hundën. Me një pambuk me solucion largoi gjithë papastërtitë e natës dhe nisi të trukohej ngadalë. Ndërsa vijëzonte lapsin e zi në sy dalloi në pasqyrë krevatin madhështor. Mbulesa e shpërndarë cep më cep me manjakëri, nga ku dalloheshin qartë lulet dhe ngjyrat e përpikta, i shtrembëruan mjekrën.

-Dreqi ta hajë! Viza e konturit të syrit i kishte shkuar shtrembër dhe mori ta fshinte me një pambuk ndërsa shkëlqente krenar dhe pa asnjë rrudhë krevati i saj i martesës. Çdo lule pranvere ishte e kombinuar me jastëçka të vegjël që Sylja i kishte qepur në forma të ndryshme: zemra, trekëndësha, katrorë, vezake dhe lule. Provoi të ngjyej përsëri sytë po i dridhej dora dhe atë herë plot përtesë vendosi ta braktiste tualetin. Mbase kalonte në qendrën e saj estetike dhe kryente ritin e grave në duart e një profesionisteje.

Gruaja i hodhi një sy qesëndisës krevatit dhe më pas hapi dollapin për të zgjedhur veshjen e saj. U vesh ngadalë por dhe në pasqyrën e komosë dalloi shtratin e ngrirë si në një vitrinë reklamash. I cingëriste nervat ai shtrat me pamje perfekte dhe përmbajtje jofunksionale. Aty s'kishte më ofshama dashurie...

...Ajo me të shoqin ishin njohur me shkuesi në vendin e tyre të origjinës në Malësinë e Madhe dhe kishin ardhur prej vitesh në kryeqytet. Iu kujtuan çarçafët e bardhë kambrikë me dantellën e bërë me grep nga ajo që i kish marrë në pajë, çarçafë që të nesërmen e dasmës u varën në degën e kumbullës të gjakosura dhe nëna e saj që qeshte tërë gaz: "Bijë nuk më paske turpëruar". Ajo kumbull që atë pranverë u tha dhe nuk bëri më fryte. Ustai i fshatit e preu dhe i bëri një ikonë që ajo e mbarte akoma në sallon, të varur. Nuk kishin ndenjur gjatë në farefisni. Ramizi kishte zbritur në Tiranë dhe brenda një viti kish hapur një fabrikë këpucësh që ecte shumë mirë. Bëheshin plot dhjetë vjet në kryeqytet, dhe 11 vjet nga martesa e saj. Ramizi vinte gjithnjë i lodhur nga puna dhe prej tre vjetësh ata e ndanin krevatin vetëm formalisht. Burri me të cilin u martua me shkuesi nuk kish dalë i besës. Fillimisht kish zbuluar aromën e re të parfumit në lëkurën e tij, më pas kishin ardhur mesazhe ndjellëse në celular dhe më pas e vërteta e hidhur. Takohej me një vajzë njëzetvjeçare. Nga ajo ditë e mallkuar kish bërë një pakt të heshtur me veten! Do heshtte! Nuk mund të humbte shtëpinë luksin dhe të mirat materiale që bashkëshorti i saj i siguronte. Zbukurohej, vishej elegante, masazhe, makinë, biznes bukurie, jetë shoqërore me gratë aristokrate të kryeqytetit. Jetë që shumë prej grave shqiptare që rropateshin në punë për 150 mijë lekë e admironin.

-Çile! Eja pak!

Gruaja shërbente prej shumë vjetësh në vilën e tyre dhe ajo ishte e kënaqur shumë me punën e saj. Përveçse ishte një grua meraklije, Çilja ishte e njohur në lagjen e tyre si rrobaqepëse. I zgjidhte tërë merak copat kambrike ose ato të atllasit dhe i sajonte në mënyrën më të mirë të mundshme, asortimentet e saj, duke parë gjithë katalogët e modës për të qenë gjithnjë e kohës.

-Kam një porosi për ty!

-Urdhëro zonjë!

-Dua të më qepësh një palë çarçafë për merak.

-I ke për dhuratë zonjë?

-Po për dhuratë divorci!

-Çfarë!? Uh ç'është ky qamet! Ku ka qepë Sylja ndonjëherë çarçafë për ksi lanetësh.

-Do të të paguaj mirë dhe do të japë dhe një shpërblim. Këto do jenë çarçafët e fundit që do bësh për mua. Dua të ma derdhësh gjithë talentin që ke...! Dua që të jenë më të bukurat. Sepse një grua ka fituar lirinë... dhe dinjitetin e saj!

Gruaja me flokët e thinjura të mbledhura pas kokës, shqeu sytë, dhe për një hop u mbajt në komo. Prej më se 15 vjetësh që kur kishte ardhur demokracia ajo me makinën e dhuruar nga gjyshja, një makinë kineze e rrallë, kryente porositë e gjithë fëmijëve që vinin në jetë, bënte pajën e dhjetëra nuseve dhe nuk i kishte dalë kurrë llafi për keq dhe qepte qefinë me dantella të mrekullueshme. Pajat e saja kur tregoheshin në sy të njerëzisë gjithnjë shquheshin për veçansinë e tyre, sepse nuk i qepte kurrë seri, por gjithnjë me një fantazi të re. Kishte rritur me këtë profesion 6 kalamaqër dhe kishte ngrysur mijëra net për të përfunduar punën shpejt. E kishte pak keq me Avdiun se këto kohët e fundit pinte raki dhe çoku i merrte ndonjë lekë fshehurazi, por ajo gjithnjë ia kishte dalë.

-I dua shpejt, për dy ditë

"Qyqja, ç'më gjeti!" mendoi Sylja me vete. "Si mund ta kundërshtonte zonjën e saj që e mbante me bukë. Por, vallaji, për kshu turpesh nuk qepte dora e saj. Ç'do thoshte lagjja për të. Gratë që ndërsa mblidheshin merreshin me historitë e njëra-tjetrës sikur nuk kishin halle për vete."

Ndërsa zonja largohej me atë vështrimin krenar dëgjoi kërcimën e derës që mbyllet. Syles i merren këmbët. Një dhimbje në të majtë të kraharorit i merr frymën dhe rrëzohet nëpër shkallë...

ARGUMENT

Kjo polemikë shpërtheu në fillim të shek. XIX, me zhvillimin e filozofisë së historisë kur shumë filozofë përcaktuan si detyrë themelore të filozofisë që të mendojë historinë. Nisur nga ky parim shihen dy qëndrime të kundërta për Aristotelin. Hegeli, edhe nga simpatia për Napoleonin, kishte një vlerësim shumë të lartë për Aleksandrin. Sipas tij, Aristoteli nuk mund të kishte qenë edhe frymëzues dhe admirues i Aleksandrit

Aristoteli dhe Aleksandri i Madh: Çfarë marrëdhënie?

"Platoni dhe Aristoteli imagjinohen me veshje të mëdha pedante. Ata ishin njerëz të ndershëm dhe si të tjerët qeshnin me miqtë e tyre. Edhe kur argëtoheshin duke bërë ligjet dhe politikën e tyre, ata i bënë duke luajtur. Ishte pjesa më vogël filozofike dhe më pak seriozja e jetës së tyre, më filozofike ishte të jetoje në mënyrë të thjeshtë dhe të qetë".

Paskal, "Pensées"

NGA PROF. DR. GJERGJ SINANI

Problemi i marrëdhënieve ndërmjet Aristotelit dhe Aleksandrit është shoqëruar me diskutime të shumta. Një drejtim i rëndësishëm i historiografisë antike, me frymëzim stoik, që e gjejmë te Eratosteni dhe Plutarku, theksojnë gjerësinë shpirtërore të Aleksandrit që ishte i shqetësuar që të bashkonte grekët dhe barbarët në një bashkësi universale (cosmopolis), përballë pikëpamjeve tradicionale të mësuesit të tij. Sipas tyre, Aristoteli e kishte këshilluar Aleksandrin që me grekët të sillej si hegjemon (shef) dhe me barbarët si sundues (despotës), të parët t'i trajtonte si miq dhe të dytët si armiq, por Aleksandri nuk ndoqi asnjë nga këto këshilla.

Kjo polemikë shpërtheu në fillim të shek. XIX, me zhvillimin e filozofisë së historisë kur shumë filozofë përcaktuan si detyrë themelore të filozofisë që të mendojë Historinë. Nisur nga ky parim shihen dy qëndrime të kundërta për Aristotelin. Hegeli, edhe nga simpatia për Napoleonin, kishte një vlerësim shumë të lartë për Aleksandrin. Sipas tij Aristoteli nuk mund të kishte qenë edhe frymëzues dhe admirues i Aleksandrit. Nga ana tjetër, shumë komentues të tjerë, kanë theksuar se Aristoteli ishte një konservator dhe shumë i lidhur me një formë politike tashmë të tejkaluar "qyteti i vogël grek". Këto dy gjykime përbëjnë edhe sfondin e diskutimeve bashkëkohore.

Korpusi i veprave të Aristotelit përbëhet nga dy kategori veprash: traktatet ezoterike, të destinuar për mësim brenda Liceut, prej të cilave, nga tradita e dorëshkrimeve na ka mbërritur një pjesë e madhe e këtyre veprave dhe dialogët, traktatet dhe letrat që quhen egzoterike, sepse ishin të destinuara për një publik më të gjerë, të cilat pothuajse kanë humbur (një letër dërguar Aleksandrit mund të jetë një përjashtim që na vjen nga dorëshkrimet arabe). Traktati *Mbi botën* (*Peri Cosmos*) i është drejtuar Aleksandrit. Edhe pse është një traktat që i dedikohet fizikës dedikimi është domethënës. Por, është një fakt i çuditshëm se nuk gjendet asnjë përmendje e emrit të Aleksandrit në të gjitha traktatet autentike të Aristotelit. Madje heshtja ndaj këtij gjenerali të madh është tepër e dukshme në tetë librat e *Politikës*. Disa aluzione mbi mbretërinë maqedonase ndodhen në kapitullin 10 të librit V, që i kushtohet shkaqeve të rënies dhe mënyrave për mbajtjen e një monarkie. Mos vallë kjo heshtje vjen nga fakti se Aleksandri denoi me vdekje nipin, Kelistenin, që Aleksandri e akuzoi për komplot dhe me këtë shpjegohet një nga hipotezat e vdekjes së Aleksandrit nga një helm i përgatitur nga Aristoteli, siç na thotë Arrieni? Arrieni na thotë se është folur shumë për vdekjen e Aleksandrit dhe cilëson si më të besueshme faktin se Antipatros ishte në origjinë të helmimit. Pas vdekjes së Kalistenit, Aristoteli ja dha helmin Kasandrit, djalit të Antipatros, që ai e solli të fshehur në thundrën e një mushke[1]. Mos vallë kjo lidhje shpjegon caktimin e Antipatros dhe djalit të tij si ekzekutues të testamentit të Aristotelit? Por edhe vdekja e Aristotelit nuk dihet me saktësi. Diogjen Laerci na thotë se Aristoteli vdiq në Chalcis, pasi u akuzua nga athinasit për shkak të lidhjeve me Aleksandrin dhe maqedonasit dhe vdiq aty "pasi piu akonitin (helm që dilte nga disa gjethe në zonat malore, Gj.S.), siç na thotë Eumèle në librin V të Historitë së tij, pasi jetoi shtatëdhjetë vet"[2]. Komentuesit thonë se Eumèle ka dashur që t'i japë Aristotelit të njejtën moshë dhe lavdi si Sokratit. A vërtet kanë vdekur të helmuar si nxënësi dhe mësuesi? Edhe në qoftë se nuk është i vërtetë ky fakt, një gjë është e sigurtë; njerëzit e ditur dhe të mëdhenj nuk i duan shumë. Por t'ja lemë historisë këto çështje dhe t'i rikthehemi problemit tonë.

Te libri V i *Politikës*, Aristoteli na thotë se mbretëritë e kanë origjinën e tyre nga shërbimet që mbretërit i bëjnë popujve të tyre dhe përmend Codros që shpëtoi athinasit, Cyrus që çliroi persët, pastaj mbretërit Lakedemonas, Molosët dhe Maqedonasit që pushtuan territoret e bashkësisë. "Në fakt, shkruan Aristoteli, të gjithë ata që i kishin bërë shërbime, ose mund t'u bënin shërbime qyteteve të tyre ose popujve të tyre, zakonisht fitonin dinjitetin mbretëror, qoftë kur e fitonin pas një lufte, nënshtrimin si Codros, qoftë kur i kishin çliruar, si Cyrus, qoftë kur themelonin një qytet ose fitonin një territor si mbretërit Lakedemonas, Maqedonasit dhe Molosët. Nga natyra mbreti do që të jetë një protektor me qëllim që t'i vendosë zotërueusit e pasurisë në mbrojtje ndaj masave të padrejta dhe të shmangë teprimet e popullit. Përkundrazi, tirania, siç e kemi përsëritur shpesh, nuk ka kurrë parasysh të mirën e përbashkët, por interesin e vet personal"[3]. Në tri raste të tjera kur i përmend maqedonasit nuk është shumë dashamirës. Filozofi përmend teprimet seksuale si shkak të vdekjes së Arkelaos dhe Filipit[4].

Në librin III të *Politikës*, Aristoteli na jep një klasifikim të detajuar të mbretërive por nuk saktëson kurrë nëse bënte fjalë për monarkinë maqedonase si një model i tipit lakonian, si një mbijetesë e mbretërive greke të kohëve heroike, si një mbretëri barbare ose si një tirani. Pasi bën inventarin e tipeve të mbretërive, ai fut edhe një formë të pestë, *pambasilea*.[5] "Por ka një lloj të tretë mbretërie ku një njeri i vetëm ka autoritetin mbi gjithçka, si çdo popull ose çdo qytet, mbi interesa të përbashkëta; ajo vendoset në të njejtin rang si qeveritë domestike: ashtu si qeveria domestike është një lloj mbretërie mbi një shtëpi, kjo mbretëri është si një qeveri domestike qoftë e një ose disa qyteteve, qoftë e një ose disa popujve"[6]. Në vazhdim, ai nuk ndalet më në këtë formë mbretërie, por ai ndalet në veçanti në çështjen nëse qeverisja absolute e një njeriu të vetëm është më e preferueshme se sa mbretëria e ligjit dhe nëse ky regjim është në përputhje me drejtësinë. Këtu, mesa duket, ai mban qëndrim ndaj teorisë së mbretit filozof të Platonit. Duhet theksuar se qëndrimi i tij është haptazi anti-monarkist. Sipas tij, një regjim ligjor është më i lartë se autoriteti absolut i një njeriu të vetëm, sepse ligji është një "arsye e çliruar nga dëshira", ndërkohë që çdo monark rrezikon të udhëhiqet nga pasioni i tij. "Kështu pra, të kërkosh që të mbretërojë ligji, kjo do të thotë të kërkosh që vetëm Zoti dhe arsyeja të mbretërojnë; përkundrazi, të kërkosh mbretërimin e një njeriu, kjo do të thotë t'i shtosh atë të një shtaze, sepse dëshira e verbër është si një shtazë dhe shpërthimi i pasioneve përmbyt qeveritarët, madje edhe njerëzit më të mirë; kështu, ligji është arsyeja e çliruar nga dëshira"[7]. Në kapitullin 17, Aristoteli thekson se ndërmjet individëve të ngjashëm dhe të barabartë, sovraniteti i një njeriu të vetëm nuk është i drejtë edhe në qoftë se monarku ka shumë merita. Mirëpo, ai fut një përjashtim, kur në një qytet, një familje, ose një individ ka merita shumë më të larta se ato të të gjithë të tjerëve së bashku, atëherë është e drejtë që kjo familje ose ky individ të ushtrojë sovranitetin dhe të gjithë t'i binden. Një individ i pajisur me të tilla merita është "si një zot midis njerëzve". Ligjet dhe rregullat që bazohen mbi barazinë nuk mund të zbatohen ndaj tij. Ndaj njerëzve të tillë nuk ka ligj, sepse ata vetë janë ligji. Në qoftë se gjendet një njeri me virtyte të tillë, çfarë duhet bërë?, pyet Aristoteli. "Siguristë nuk duhet thënë se një njeri i tillë duhet ndaluar dhe dëbuar; siguristë as se duhet komanduar: është njëlloj si të pretendohet të komandohet Zeusi, përmes një ndarje pushteti. Pra, e vetmja gjë që mbetet dhe që duket e bazuar në natyrë, është që t'i binden të gjithë një njeriu të vetëm me të gjitha favoret; dhe kështu, njerëz si ai do të jenë përjetësisht mbretër në qytetet e tyre"[8]. Ky refleksion mbi mbretërinë absolute dhe mundësia e daljes së një njeriu të jashtëzakonshëm, të ngjashëm me perënditë, ka rëndësi të theksohet sepse ve në diskutim vetë ekzistencën e *polisit* që për Aristotelin është një "bashkësi të barabartësh". Në filozofinë e Aristotelit, qyteti (*polisi*), që përbën qëllimin e evolucionit njerëzor, në kuptimin teleologjik të termit, nuk shënon domosdoshmërisht pikën finale të tallandisjeve të bashkësive njerëzore. Nga natyra, njeriu është i destinuar të jetojë në qytet, por nuk është kështu për shtazët e egra dhe as për perënditë. Njerëzit e ngjashëm me shtazët e rrezikojnë qytetin, por dalja e një njeriu hyjnor do të shpinte, qoftë edhe përkohësisht, në shkatërrimin e bashkësive qytetare në favor të një monarkie absolute, qoftë në kuadrin e një qyteti, qoftë në një kuadër perandorak. Këto analiza që jep Aristoteli nuk shoqërohen me asnjë shembull, gjë që është e rrallë te Aristoteli, i cili në analizat e veta zakonisht u drejtohet shembujve. Mos vallë Aristoteli e konsideronte Aleksandrin si një perëndi midis njerëzve dhe regjimin e tij si një regjim të justifikueshëm? Ajo që është e sigurtë te Aristoteli, pavarësisht kritikave, është fakti se ai ishte tepër i vëmendshëm ndaj fenomeneve politike të mëdha të kohës së tij dhe, në kuadrin tonë, daljen e një tipi të ri monarkie.

Për më tepër, nipi i Aristotelit, Kalisteni, ishte shoqërues i Aleksandrit si biograf zyrtar. Pasi u soll si një lajkatar pranë Aleksandrit, ai ju kundërvu mbretit kur ky i fundit deshi t'u impononte maqedonasve dhe grekërve vullnetin e tij absolut. Më vonë Aleksandri e dënoi me vdekje duke e akuzuar se ishte nxitës i konspiracionit të pazhëve. Ndoshta Kalisteni nuk veproi me kujdes siç e kishte porositur daja i vet, por as nuk është e sigurtë se kjo ngjarje shpuri në një ndarje totale ndërmjet Aleksandrit dhe mësuesit të tij, pasi Nikanori, djali i adoptuar i Aristotelit, në vitin 324 ishte një nga njerëzit më të besuar të Aleksandrit. Po kështu, është e mundur që filozofi mbajti marrëdhënie të mira edhe me Antipatros, që, pas vdekjes së Aleksandrit, në testamentin e tij Aristoteli e caktoi si ekzekutues të testamentit dhe me Aleksandrin, përmes Antipatros, edhe kur marrëdhëniet ndërmjet këtyre dy burrave u tendosën. Gjithashtu, është e sigurtë që ka pasur një korespondencë ndërmjet Aristotelit dhe Aleksandrit. Ciceroni i thotë Atticusit se për t'i shkruar Çezarit do merrte si model një letër të Aristotelit për Aleksandrin. Edhe Diogjen Laerci përmend dy traktate ezoterike që Aristoteli ja drejtonte Aleksandrit, *Mbi mbretërinë* dhe *Mbi kolonitë*, si dhe katër letra. Po sipas Laercit, që jetoi në shek. III pas Krishtit, është e sigurt se letrat e Aristotelit për Aleksandrin janë shumfishuar.

Nga historia njihen disa shkrime apokrife që njihen si *Roman për Aleksandrin* të shkruara nga Psudo-Kalisteni, ku tregohet se pas çdo ekspedite Aleksandi i shkru-

...NGA NUMRI I SHKUAR

"Milosao" e këtij numri ishte e ndryshme, por jo me shumë pretendime. Mendonim se mund të bënim shumë më tepër, por shkuam thjesht deri këtu. Shkrimi kryesor iu la koleksionistit të vjetër veteran Bajram Peçi, që kish përgatitur diçka lidhur me imazhin e heroit sa i përket koleksionit të portreteve, medaljeve dhe portreteve të Skënderbeut. "Ka qenë koleksionisti i veprave të artit, një personalitet i shquar i Rilindjes italiane, Paolo Giovio (1483 –1552), i cili, falë pasionit të tij, besohet se ka bërë të mundur të mbërrijë deri në ditët tona pamja e heroit kombëtar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Peshkop, mjek, fizikant, historian dhe biograf, ka hyrë në të famshmit si krijuesi i muzeut "Uomini illustri", me koleksionin më unik që ishte parë me vepra arti në Evropën Mesjetare", na e solli ai. Autori është realisht shumë skrupuloz dhe ka kontribuar shumë për këtë lëmë.

Redaktori shtroi një shkrim të tijin sa i përket Piramidës dhe vijoj të mbrojë kauzën e saj për t'u kthyer në Bibliotekë Kombëtare. Ka marrë feedback pozitive dhe mbi të gjitha përkrahje nga shumë njerëz, por duket se destini i saj nuk ndryshon për momentin.

Një pjesë nga libri teorik i Gazmend Krasniqit u botua në këtë numër. Redaktorit nuk i erdhi mirë që ai e kishte botuar dhe më parë në facebook. Të paktën kështu u sinjalizua.

Kujtim Dashi erdhi me një parabolë simpatike me titullin "Harold Bloom në Morinë të Kukësit". Çuditërisht përkoi me tmerrin e protestave që ndodhën aty. Redaktori shkroi se autori shquhet për humorin e thellë dhe parabolat e këndshme në letërsi. Alegoria në këtë tregim thotë shumë gjëra për kohën tonë...Na erdhi mirë që autori e vlerësoi botimin.

Ndërkohë që në këtë numër patëm vend dhe për një cikël të Zyhdi Dervishit me frymën e tij shumë patriotike dhe një lloj përshtatje të tij të vështirë me këtë lëmë...Për fatin e keq dhe për të dytën javë, layout ka gabuar rëndë me heqjen e një pjesë që përbën thelbin e titullit.

Profesor Gjergj Sinani na solli një shkrim interesant sa i përket lidhjet së Aleksandrit të madh me Aristotelin, mësuesin e tij. I trajtuar me skrupulozitetin e zakonshëm të profesorit do të vazhdojë edhe në këtë numër. Redaktori ia kish vonuar por profesori e kish marrë me shumë sportivitet. Ky numër ishte i qetë, jo shumë interesant për të mos thënë pak i mërzitshëm. Redaktori duhet të punojë më shumë me layout që shpreh një lloj papërgjegjshmërie të habitshme.

ante Aristotelit për t'i treguar ato që kishte parë. Në përgjigje, Aristoteli e përgëzonte, i jepte këshilla, ose i kërkonte saktësime. Për këto marrëdhënie të ngushta flet edhe Hegeli, i cili thekson se "Aleksandri mori masa të kujdesshme që bimët dhe kafshët e reja që do të gjente në Azi t'i dërgoheshin Aristotelit, në formën e tyre natyrore, ose në formën e vizatimeve dhe përshkrimeve"[9]. Në shek. VIII, disa nga këto letra u përkthyen në gjuhën arabe nga sekretari i kalifit omejad të Damaskut që mbretëroi nga 724 deri më 743. Vlen të theksohet se këto letra figurojnë në tekstet e para greke që u përkthyen në arabisht. Përkthimi i traktateve filozofike dhe shkencore filluan rreth një shekull më pas. Me sa duket, ky interes për këto letra shpjegohet me faktin e analogjisë politike. Ashtu si Aleksandri edhe Omejadët duhej të organizonin një perandori që e fituan shumë shpejt dhe, ashtu si Aleksandri, duhej të mbanin parasysh se si t'i trajtonin popujt e pushtuar dhe sidomos kuadrot persë të perandorisë së vjetër sasanide. Ndërmjet shumë autorëve që janë marrë me këtë korrespondencë, meriton të vihen në pah punimet e Jozef Bielawski, të botuara në vitin 1970, ku ai studion katër letra që Aristoteli ja ka dërguar Aleksandrit në katër doreshkrime që ndodhen në Haja Sophia, doreshkrimet e Koprulu dhe një doreshkrimi në Bibliotekën e Vatikanit[10]. A janë vërtet letra të Aristotelit dhe a është vënë dorë në to nga autorë anonime, kjo është një çështje e debatueshme ndërmjet historianëve. Ajo që na intereson ne, është nxjerrja në pah e mendimit politik që shpaloset në këto letra.

Përgjithësisht letrat fillojnë me shprehje admiruese për bëmat e Aleksandrit, por shpejt ai i këshillon mbretit të ri që t'i japë ligje këtij shteti të madh tani që u vendos paqja. Ai i thotë Aleksandrit se është e lehtë që të pushtohet një vend i madh, por është e vështirë që të mbahet në një gjendje të lulëzuar, siç na tregon historia e perandorive të lashta aziatike. Që një vend të ketë një legjislacion unik, i duhet një mbret që të nxjerrë ligje dhe të bëjë që ato të respektohen. Sipas filozofit, karakteri i sovranit dhe sjellja e tij e drejtë kanë një rëndësi thelbësore, sepse si të jetë princi ashtu do të jetë edhe vendi. Letra vazhdon edhe me një seri këshillash. Më së pari ai i thotë se me subjektet e tij duhet të sillet jo si një zot pronar, por si kryetari i familjes me të afërmit. Autoriteti i sovranit duhet të bazohet mbi dashurinë dhe admirimin e subjekteve, gjë që shumë sovranë e harrojnë dhe duan ta vendosin respektin përmes forcës, por që në fakt nxisin urrejtjen dhe përbuzjen. Një Sovran i mirë duhet dhe admirohet kur në vend që të kujdeset vetëm për kënaqësitë e veta, mendon për lumturinë e subjekteve të tij. "Ti, i shkruan filozofi, nuk duhet të zemërohesh kundër subjekteve të tu, në qoftë se ata përpiqen që të barazohen me ty në gjërat e lëvdueshme. Në përgjithësi këta janë njerëz të mirëlindur, që gjallërohen nga qëllime fisnike, më e mira do të ishte që t'u tregoje atyre që ti ndaj tyre je superior, por mos e konsidero konkurrencën e tyre si një atentat kundër pushtetit tënd. Ai që vepron me drejtësi, nuk ka nevojë t'i trembet Zotit"[11].

Nga këto letra ne mësojmë edhe disa tipare të karakterit të Aleksandrit, që pak a shumë korespondojnë me ato që na përshkruan Plutarku. Sipas autorit të letrës, ai shkruan se Aleksandri bashkon në vetvete drejtësinë dhe krenarinë, gjenerozitetin dhe ashpërsinë, të cilat, bashkuar edhe me suksesin, zgjojnë një admirim të madh. Gjithashtu, Aleksandri i përbuzte denoncuesit dhe spiunët dhe ky është një nga virtytet kryesore të sovranëve. Autori i letrës, kur përshkruan tiparet e sovranit të përsosur, ai konstaton se sovrani është i madh në masën që dhe subjektet e tij janë të mëdhenj dhe se është më mirë të qeverisësh njerëz të lirë se sa skllevër. Qëndrimi i një sovrani të vërtetë është si ai i babait ndaj fëmijëve, ndërsa ai i një tirani është ai i një zotërie kundrejt skllevërve. Ndërsa mbreti i Persisë i quan skllevër jo vetëm subjektet, por edhe fëmijët e tij. Sovrani nuk duhet të harrojë dy virtyte, drejtësinë dhe gjenerozitetin. Gjithashtu, sovrani duhet t'i shmangë këshillatërët e këqij që përpiqen që t'i imponojnë atë që është në favor të tyre dhe jo në të mirë të sovranit. Vlerësimi vjen nga fisnikëria e karakterit, arti i zotërimit të armëve dhe nga një qeverisje e drejtë e shtetit. Sovrani nuk duhet të ketë frikë se humb autoritetin duke qenë i mirë për subjektet e tij. Në një nga letrat, autori thekson se koha e fshin kujtimin e veprave të mëdha, por mbetet vetëm dashuria në zemrën e njerëzve. Aleksandri duhet të kërkonte një lavdi të tillë, duke realizuar kështu idealin grek të njeriut.

Vlen të theksohet se Aristoteli i kushton një pjesë të madhe drejtësisë që duhet të karakterizojë një sovran. Aleksandri duhet t'i arrijë qëllimet e tij përmes drejtësisë, sepse kështu do të jetë model edhe për të tjerët. Pushteti duhet zbatuar njëlloj si për popullin dhe të zgjedhurit dhe ky është burim i prosperitetit për të gjithë. Sovrani duhet gjithmonë të vëzhgojë ligjet dhe këshillatërët duhet t'i zgjedhë njerëz të ndershëm dhe të devotshëm. "Sovrani duhet të ndjekë drejtësinë dhe kush vepron në mënyrë të drejtë drejtohet drejt të vërtetës. Shumë njerëz thonë: "ja një sovran", por në të vërtetë ai urrehet dhe është tiranik. Gjithashtu, nuk ka detyrimisht drejtësi aty ku ka një sovran. Përsa i takon drejtësisë, ajo në të vërtetë nuk pranon devijime; ajo është mbi çdo gjë tjetër dhe sovrani nuk është i vetmi zotërues"[12]. Drejtësia duhet të shpërndahet në mënyrë të barabartë, si për të fortët dhe për të dobëtit.

Mbreti, i shkruan më tej Aristoteli, duhet të flasë ngadalë dhe me refleksion, në mënyrë logjike dhe të mbajë gjithmonë parasysh qëllimin final. Këtu, Platoni mund të shërbejë si shembull. Mbreti nuk duhet të rendë pas arit dhe argjendit, sepse ato nuk kanë atë vlerë që u atribuojnë njerëzit dhe nuk ja vlen që t'i kërkosh për t'i pasur. Më mirë ja vlen që të shqetësohesh për atë që perfeksionon dhe praktikon virtytet. Mbreti duhet të dëgjojë filozofët dhe të dituriti dhe jo gjërat sensuale si të ngrënit, pijen dhe grumbullimin e pasurisë, sepse të gjitha



këto kanë pak vlerë. Mbreti duhet të mendojë për drejtësinë dhe të drejtën, ndryshe fatkeqësia do të bjerë mbi popullin dhe shtetin. Me qëllim që pasuria dhe pasionet të mos e shkatërrojnë, i drejtohet autori i letrave Aleksandrit "Ndiq rrugën e të dituriti Euklid në butësi dhe tolerancë, ec në rrugën e Platonit për moderacionin, me qëllim që të arrish në nivelin e Pitagorës për yjet (në njohjen e yjeve) dhe në nivelin e Arkimedit në artin e ndërtimit të makinave... Dije se shkenca është stolia e mbretërve dhe prova është se njerëzit e lirë nga tirania do të glorifikojnë shkencën tënde dhe bukurinë e sjelljes tënde dhe t'i do të jesh i lëvduar për shumë kohë pas vdekjes"[13]. Dhe në fakt, asnjë mbret nuk ka gëzuar lavdinë e Aleksandrit. Mos vallë një pjesë e kësaj lavdie Aleksandrit i vjen nga këshillat e filozofit?

Një nga këshillat që ka tërhequr vëmendjen e studjuesve ka të bëjë me qëndrimin ndaj persëve. Për hir të lavdisë dhe për të përjetësuar madhështinë e tij, autori i këshillon Aleksandrit që të zhvendosë popullsinë e Persisë dhe se ishte e drejtë të sulmohej Persia dhe të paguante për dëmet që u kishte shkaktuar grekërve. Kështu do të vinte paqja dhe njerëzit do të jetonin në një shtet dhe nën drejtimin e një mbreti. Njerëzit do t'i kushtoheshin edukimit dhe praktikës më të lartë dhe më fisnike, filozofisë. Sigurisht, për mendimin tonë sot kjo duket si një minus për Aristotelin, por ne duhet ta vendosim veten në mënyrën si mendonin njerëzit në atë kohë. Detyra e historisë është pikërisht të mendojë rreth ideve dhe motiveve që frymëzonin njerëzit në veprimet e tyre në atë kohë. Ata mendonin për madhështinë e Greqisë dhe asaj i takonte roli drejtues dhe civilizues. A nuk kishte shkruar Aristoteli te *Politika* se "Barbarët duke qenë nga karakteri natyrshëm më servilë se *Helenët* dhe popujt e Azisë më servilë se ata të *Europës*, ata e suportonin pushtetin despotik pa asnjë shqetësim"?[14]. Madje, Aristoteli e konsideronte Greqinë edhe më lartë se Europa, prandaj Greqisë, edhe nga pozita gjeografike, i takonte roli drejtues.

Është e vërtetë se Aristoteli në këto letra nuk e merr në mënyrë të drejtëpërdrejtë idenë e shprehur te *Politika* sipas së cilës barbari nga natyra është skllav. Nga letrat studiuesit kanë vënë në pah disa mospërputhje me mendimin politik që shpaloset te *Politika*. Te letrat vihet re një lloj hezitimi në lidhje me barbarët ndërmjet dy konceptimeve; herë i konsideron barbarët, si njerëz inferiorë dhe të destinuar nga natyra për skllavëri, herë i konsideron si qenie të papërsosura të krahasueshëm me fëmijët ose me grekët në kohërat antike. Në këtë kuptim të dytë mund të gjejmë përputhje të ideve politike të Aristotelit me ato të letrave, në kuptimin se ndërmjet grekëve dhe barbarëve, të cilët janë bërë subjekt të një mbreti legal dhe mirëbërës, atëherë dallimet ndërmjet tyre do të zbuten dhe *philis* (miqësia) do të bëhet e mundur.

Në qoftë se do provohej se letrat i përkasin Aristotelit, atëherë mund të supozohet se mendimi politik i tij ka njohur një evolucion mjaft kompleks. Ndoshta, përballë sukseseve të Aleksandrit, Aristoteli mund të ketë hequr dorë nga konsiderimi i *polisit* si forma më e lartë e organizimit politik dhe mund të ketë mbështetur dhe frymëzuar krijimin e një perandori ekumenike. Nisur nga kjo hipotezë këto letra pasqyrojnë nga njera anë, frikën e Aristotelit se mos Aleksandri shndërrohej në një tiran (këshillat mbi ligjin, drejtësinë dhe virtytet e sovranit e tregojnë këtë shqetësim) dhe, nga ana tjetër, shpresën për një paqe dhe miqësi universale. Derisa problemi i autenticitetit të letrave mbetet i pazgjidhur, mund të supozohet se letrat i përkasin periudhës romake, sepse temat politike që trajtojnë si mbretëria legale universle dhe e mirë, paqja ndërmjet njerëzve, kundërvënia ndërmjet njerëzve të ndershëm dhe turmave popullore, janë tema të trajtuara në periudhën antoniane, para se Mark Aureli të bëhej perandor. Letrat i veshin Aristotelit, këshilltar i Aleksandrit, pikëpamje mjaft të ngjashme me ato që qarkullonin në kohën kur Plutarku shkruante traktatin *Mbi fatin e Aleksandrit*, domethënë bashkimin e njerëzimit nën drejtimin e një mbreti të mirë. Autori i letrave, që mesa duket e njeh mirë veprën e Aristotelit, i atribuon filozofit idetë e veta për t'u dhënë sa më shumë autoritet. Letrat, duke u bazuar në një ambient grek, mund t'i kenë shërbyer një propagande politike në favor të një principate të moderuar. Të mos harrojmë se Plutarku e shkroi veprën në periudhën romake kur filozofia sunduese ishte stoicizmi dhe epikurianizmi që e vinin theksin jo te *polisi*, por te *kozmopolisi*.

Si përfundim, filozofisë nuk i mbetet gjë tjetër veçse të presë fjalën e historianit për pyetjet që dalin në studimin e marrëdhënies së këtyre dy burrave të mëdhenj, njeri në fushën e mendimit dhe tjetri në fushën e aksionit, të cilët edhe sot na mrekullojnë me veprën e tyre. Megjithë, nuk mund të mos biem dakort me plakun Hegel, i cili në veprën madhore, *Leksione mbi filozofinë e historisë*, afër fundit të jetës së vet, do të shkruante për këta dy burra: "Aleksandri u rrit nga mendimtari më i thellë dhe më i kuptueshëm i antikitetit, nga Aristoteli, dhe edukimi që i denjë për njeriun që ju ngarkua. Aleksandri u inicua në metafizikën më të thellë: kështu natyra e tij u purifikua në mënyrën më të përsosur dhe, për më tepër, u çlirua nga lidhjet e opinionit, të trashësisë dhe shfaqjeve të kota. Aristoteli e la këtë natyrë të madhe po aq shpirtkulluar sa ç'ishte, por i nguliti ndërgjegjen e thellë që është e vërteta, duke e bërë shpirtin plot gjeni siç ai ishte, një shpirt plastik ashtu si një sferë që lëviz lirshëm në eterin e saj"[15]

1 " Alexandre le Grand, Histoire et dictionnaire ", Robert Laffont, Paris, 2004, f. 422.
2 Diogène Lewrce, Veper e cituar, f. 561.
3 Aristote, Politique, tel Gallimard, Paris, 1993, f. 182.
4 Po aty, f. 184.
5 Për më shumë detaje shiko: Nagle Brendan, Alexander and Aristotle's Pambasileus, te L'antiquité clasiques, T. 69, 2000, pp. 117 - 132.
6 Aristote, Politique, f. 105.
7 Aristote, Politique, f. 109.
8 Aristote, Politique, f. 102.
9 Aristote, Politique, f. 102.
10 G.W.F. Hegel, Leçons sur l'histoire de la philosophie, Vep. e cituar, f. 506.
11 Për historinë dhe detaje të tjera të këtyre letrave shiko : Jozef Bielawski, Lettres d'Aristote à Alexandre le Grand en version arabe, Gallica.
12 Jozef Bielawski, Lettres d'Aristote à Alexandre le Grand en version arabe, Gallica, f. 16.
13 Jozef Bielawski, Lettres d'Aristote à Alexandre le Grand en version arabe, Gallica, f. 17-18.
14 Jozef Bielawski, Lettres d'Aristote à Alexandre le Grand en version arabe, Gallica, f. 21.
Aristote, Politique, f. 103.
16 G.W.F. HEGEL, Leçons sur la Philosophie de l'histoire, Vrin, 1963, f. 207.

ARGUMENT

Autori është nismëtar i një përpjekjeje të jashtëzakonshme me një grup intelektualësh hebrenjsh dhe shqiptarësh për të përcjellë në vendin tonë bibliotekën e njohur të Norbert Joklit... Madje, në kokën e tij është e ravijëzuar qartë i gjithë procesi dhe vendosja e kësaj trashëgimie të jashtëzakonshme për Albanalogjinë

Apeli i intelektualëve: Sillni bibliotekën e Prof. Joklit në Shqipëri

Lasgushi me Asdrenin dhe Joklin

TRI AMANETE NË NJË

NGA AGRON ALIBALI

"Ma nis letrën për Joklin ta nënshkruaj, dhe ta kthej menjëherë me postën e parë" do të më thoshte në telefon Johanna Gerechter Neumann në mars 2017. Fjala ishe për nismën private dhe të pavarur, për të cilën kishim biseduar kaherë: kthimi në Shqipëri i trashëgimisë së çmuar bibliotekare dhe albanologjike të Prof. Norbert Joklit.

Johanna Gerechter kishte lindur në Hamburg në vitin 1930. Në vitin 1939 familja e saj u strehua në Shqipëri, ku edhe i shpëtoi zezonës naziste të Holokaustit. Më vonë ajo jetoi në Amerikë, ku u mori përsipër si mision të jetës t'i thoshte botës mbarë për aktin fisnik dhe vetmohues të shqiptarëve ndaj hebrenjve. Shpesh bisedonim edhe për fatin e zi të Joklit, që nuk kishte mundur të shpëtonte dot...

Letra jonë ishte në trajtën e një kërkese drejtuar Komitetit Amerikan të Trashëgimisë Kulturore me Jashtë. Ajo bazohej në Marrëveshjen kulturore SHBA - Shqipëri të vitit 2004.

Sikurse Faik Konica me bibliotekën e vet, edhe Norbert Jokli ia kishte lënë trashëgim popullit shqiptar tërë pasurinë e tij librare dhe intelektuale. "*Kam dëgjuar që Jokli i ka lënë me testament bibliotekën e tij shtetit shqiptar*" do t'i shkruante Fan S. Nolit Hito Sadiku më 1946. Vullnetin e Joklit, madje, e pat përjellë në letër edhe prof. Eqrem Çabej, nxënësi dhe miku i ngushtë i tij. Përmes një "deklarate" amanet, 61 vjet më parë, prof. Çabej na përçon si më poshtë:

"..Carlo Tagliavini, Profesor i Gjuhësisë në Universitet të Padovës në Itali, më tha mua të nënshkruarit në vetën e atij viti [1942, shënim imi, A.A.], në Romë, se Prof. Jokli, disa muaj paa se të zhdukej, i kishte thënë atij në Vjenë, që gjithë pasurinë e tij, e pasurinë shkencore (me dorëshkrime, bibliotekë, etj.), me akt zyrtar ja kishte falur popullit shqiptar (gjermanisht dem albanischen Volk). Unë di e në bibliotekën e tij ai ka pasur dhe një dorëshkrim të daktilografuar të Baron Nopcas përmbi Kanunin e Lekë Dukagjinit. Ndër dorëshkrimet e Prof. Joklit ka qenë dhe forma e parë e Fjalorit etimologjik të gjuhës shqipe.

Duke u kthyer unë në verën e 1944 në atdhe, në Vjenë u takova me Kolë Rrogën. Ky më kumtoi se biblioteka e Prof. Joklit bashkë me dorëshkrimet etj aso kohe gjindej në një dhomë të mbyllur në Bibliotekën Nacionale të Vjenës.

Tiranë, 20 mars 1957 Dr. Eqrem Çabej."

Prof. Eqrem Çabej ndërroi jetë në vitin 1980. Bashkë me veprën e tij madhore, Çabej i la brezit tonë edhe amanetin e amanetit.

Letra jonë, e nënshkruar nga Znj. Neumann dhe dy të tjerë, mban datën 7 mars 2017. Shtatë javë më pas, me 26 prill 2017, Johanna Neumann do të ndërronte edhe ajo jetë. Kthimi i trashëgimisë së Joklit në Shqipëri do të ishte misioni i fundit i saj në këtë botë. Me ikjen e Johannës, barrën e nënës e mori përsipër i biri, Benjamin. Tashmë amanetit të Joklit, dhe deklaratës së Çabejt, i është bashkuar edhe misionin i fundit i Johanës. Ose tre amanete të bashkuara në një.

Më poshtë po botojmë për herë të parë kërkesën me të cilën është vënë zyrtarisht në lëvizje mekanizmi për kthimin në Shqipëri të trashëgimisë së paçmuar albanologjike të Prof. Norbert Joklit.

Agron Alibali

Post Scriptum - A nuk e meriton trashëgimia e Joklit të strehohet në ndërtesën e riaftësuar të ish-Qendrës Ndërkombëtare të Kulturës, të cilën Bashkisë së Tiranës i është bërë thirrje për t'ia kthyer shtetit shqiptar si aneks i ri të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë?

Së Nderuarës Lesley Weiss
Kryetare
Komiteti i Shteteve të Bashkuara për Ruajtjen e Trashëgimisë së Amerikës Jashtë
633 3d Street NW
Suite 515
Washington, D.C. 20226
Re: Biblioteka dhe Arkiva e Prof. Norbert Jokl
7 Mars 2017

E nderuara Kryetare Weiss,

Ne jemi një grup qytetarësh amerikanë me prejardhje hebraike dhe shqiptare dhe mbështesim fuqimisht misionin fisnik dhe punën e rëndësishme të Komitetit tuaj..

Po ju drejtohemi për një çështje të rëndësishme të trashëgimisë kulturore që përfshihet brenda misionit dhe tagreve të Komitetit tuaj.

Konkretisht, jemi të shqetësuar dhe kërkojmë ndihmën tuaj për transferimin nga Austria në Shqipëri të Bibliotekës dhe Arkivës së Prof. Dr. Norbert Jokl, studiues i shquar me prejardhje hebreje, i cili është viktimë e Holokaustit.

Sipas skedës së OSS, të hartuar nga *Harvard Intelligence Group* në vitin 1943, Dr. Jokl ishte "*një linguist me famë botërore, dhe ekspert i shquar në lëmin e gjuhëve Into-Europiane dhe Sllave*".

Duke ndjerë se jeta e Prof. Joklit ishte në rrezik, autoritetet e Shqipërisë së pushtuar nga Italia e ftuan atë në vitin 1941 që të shpërngulej në Shqipëri. Prof. Joklit iu ofrua strehim dhe detyra e Kryebibliotekarit të Shqipërisë.

Prof. Jokl dëshironte të shpërngulej në Shqipëri. Ai kishte shumë lidhje atje, ishte gjerësisht i respektuar, dhe vendi ishte bërë strehë për hebrenjtë europianë që arritën të shkonin atje. Mirëpo autoritetet naziste nuk e lejuan Prof. Joklin të merrte me vete bibliotekën, dorëshkrimet dhe arkivën e tij të çmuar. Prof. Jokl refuzoi të largohej nga Vjena pa to. Ndërkohë që autoritetet shqiptare po interesoheshin ngutshëm për *laissez-passer*, Gestapoja e arrestoi Prof. Joklin dhe e dërgoi në kampin e shfarosjes në Maly Trostenets në Bjellorusi, ku vdiq në maj 1942. As sot Prof. Jokli nuk e ka një varr.

Sipas informacionit në faqen e internetit të Universitetit të Vjenës, **Dr. Jokl ia la trashëgim Shqipërisë bibliotekën e tij.** Pavarësisht nga kjo, Biblioteka

"*u konfiskua dhe 'arianizua', akt ky i mbështetur nga Viktor Christian, Dekan i Shkollës së Filozofisë në Universitetin e Vjenës dhe Paul Heigl, drejtor i përgjithshëm i Bibliotekës Kombëtare të Austrisë. Koleksoni i pasur iu dorëzua Bibliotekës Kombëtare "si huazim" në vitin 1942 dhe u shtetëzua në vitin 1946.*" Katharina Kniefacz, tek ëëë. gedenbuch, univie.ac.at].

Norbert Jokli

Biblioteka dhe Arkiva e Prof. Joklit janë "pasuri me vlerë të posaçme" për trashëgiminë tonë kulturore. Për arsyet e përcjella më poshtë, ne invokojmë Marrëveshjen midis SH.B.A-së dhe Shqipërisë për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Disa Pasurive Kulturore të 12 korrikut 2004 [në vijim Marrëveshja.

Në bazë të kësaj Marrëveshjeje, ne kemi nderin t'ju përcjellim kërkesat tona si më poshtë:

(i) Këshilli i Përbashkët, i referuar në Nenin 6 të Marrëveshjes, ta përcaktojë Bibliotekën dhe Arkivën e Joklit si **pasuri me vlera të posaçme për trashëgiminë kulturore,** dhe ta rendisë si të tillë në përputhje me Nenin 5 të Marrëveshjes;

(ii) Komiteti i SHBA për Ruajtjen e Trashëgimisë së Amerikës Jashtë të shqyrtojë mundësin e angazhimit me autoritetet austriake për përmbushjen e dëshirës së fundit të Dr. Joklit dhe për transferimin pa vonesë të Bibliotekës dhe Arkivës së Dr. Joklit nga Biblioteka Kombëtare e Austrisë tek Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë;

(iii) Komiteti i SHBA për Ruajtjen e Trashëgimisë së Amerikës Jashtë të mund t'i kërkojë palës shqiptare në Këshillin e Përbashkët për ndërmarrjen e hapave të posaçme që, pasi të transferohen për tek Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë, Biblioteka dhe Arkiva e Joklit të mbrohen dhe ruhen më së miri.

Nëse sa më sipër do t'ju nevojiten informacione të tjera, lutemi na kontaktoni lirisht.

Ju falenderojmë për kohën dhe vëmendjen tuaj për këtë problem të rëndësishëm, dhe mbetemi në pritje të përgjigjes tuaj.

Tuajët me besë,

Johanna Neumann [1930 - 2017]
Mbijetuese e Holokaustit
U.S. Holocaust Memorial Museum

Van Sotir Christo
Konsulli i Përgjithshëm i Ndërit i Shqipërisë në Massachusetts

Agron Alibali
Senior Fellow
University of Massachusetts ,Boston

Bashkëlidhur; Skeda e OSS për Prof. Jokl's OSS
Letër për Prof. Joklin nga autoritetet shqiptare
Për dijeni, Sh. S. Floreta Faber, Ambasadore e Republikës së Shqipërisë në SHBA.

Opinioni i Ditës

Mësime nga zhgënjime “emblematike”

Dr. Jorgji KOTE

(vijon nga faqja 1)

... Park Geun Hye për 16 nga 18 akuza të rënda, që variojnë nga shpërdorimi i pushtetit, detyrimin me forcë për ryshfete, korrupsion, rrjedhje të informacionit sekret etj. Ishte presidentja e 11-të jugkoreane, një makinë e vërtetë elektorale e quajtur “Mbretëresha e Zgjedhjeve”. Mirëpo nga fundi i mandatit, niveli i popullaritetit të saj ra në 4 për qind, pas protestave masive që e detyruan të jepte dorëheqjen deri në dënimin e saj.

Në fakt, ky fund i turpshëm është në vazhdën e shumë disfatave të tjera të rënda liderë(ë) të shquar shteti, ndaj janë zhgënjime “emblematike”.

Një javë më parë u nda nga jeta në moshën 81-vjeçare W*innie Mandela*, bashkëshortja e dytë e legjendës së l*uftës kundër apartheidit, Nelson Mandela.* Zonja e ndjerë nuk ishte vetëm mbështetësja më e vendosur gjatë 28 viteve të rënda të burgosjes së tij politike, por edhe luftëtare e madhe kundër shtypjes, dhunës dhe persekutimit dhe parlamentare e shquar. Ndonëse mesazhet ngushëlluese nuk munguan, ra në sy se nderimi për Zonjën e Parë të dikurshme të Afrikës së Jugut ishte larg formatit të saj të zakonshëm.

Kjo shpjegohet me zhgënjimet e shumta që ajo shkaktoi pas viteve ‘90, kur Nelson Mandela u zgjodh Presidenti legjendar i Afrikës së Jugut. “Prapësitë” filluan me divorcin më 1996, që vijuan me kritikat dhe akuzat e shumta ndaj saj për etje për pushtet, bashkëpunim në rrëmbime dhe dhunime të të rinjve, mashtrim dhe korrupsion. Vetëm statusi i mëparshëm e shpëtoi atë nga burgimi, duke u mjaftuar me gjoba të majme.

Po në Afrikë, *Robert Mugabe* njihet si luftëtar i rezistencës së majtë kundër shtypjes dhe diskriminimit dhe për 13 vjet ishte i burgosur politik. Gati 40 vite më parë, ngjiti shkallët e pushtetit si kryeministër dhe president me pritshmëri të mëdha publike. Por, nuk vonoi dhe ai u bë diktator i egër si Mobutu fqinj, dhunues i të drejtave të njeriut, mashtrimit dhe korrupsionit. Ndonëse në moshën 93 vjeç, nuk pranonte kurrsesi të “shkulej” nga pushteti, derisa dhjetorin e kaluar u detyrua pas një puçi të mençur ushtarak të tërhiqet, por pa i hyrë gjemb në këmbë.

Një shembull shumë më trondites jep në Birmani ose Myamar emblematikja e dikurshme 73-vjeçare, *Aung San Suu Kyi, liderja e partisë në pushtet “Liga Kombëtare për Demokraci” . Nga viti 2015, ajo është* praktikisht kryeministre dhe ministre e Jashtme. Në fakt, do të ishte presidente, por Kushtetuta nuk e lejon për shkak të fëmijëve me shtetësi britanike.

Aung San Suu Kyi ka qenë 21 vite rresht e burgosura më e madhe politike e regjimit ushtarak birmanez, nga të cilat 15 vjet në arrest shtëpie.

Ndaj, “Zonja” siç e thërrasin, u kthye në simbol të rezistencës kundër dhunës dhe shtypjes politike të regjimit ushtarak dhe në ikonën e moralit.

Falë dhe mbështetjes masive të komunitetit ndërkombëtar, partia që ajo drejton erdhi bindshëm në pushtet në vitin 2015 me 86 për qind të votave, me shpresën e madhe të ndryshimit.

Ndaj, edhe këto tri vitet e fundit nuk mbeti kancelari dhe lider kalibri në botë pa e pritur San Suu Kyi me nderimet më të mëdha të mundshme. Pas “Nobel për Paqe” në vitin 1991, ajo është lauruar me çmimet dhe dekoratat më të larta nga shumë vende dhe organizata botërore.

Mirëpo, në vend të kthesës së shumëpritur, “Zonja” heshti, madje lejoi dhe legjitimoi dëbimet e dhunshme masive të qindra mijëra myslimanëve Rohingya për në Bangladeshin fqinj; një spastrim etnik i paparë në botën e sotme të qytetëruar! Zhgënjimi dhe indinjata ndërkombëtare ndaj saj vazhdon të jetë e jashtëzakonshme. Puna ka arritur deri aty sa të kërkohet revokimi i “Nobel për Paqe”, ndërkohë, kështillat bashkiake në Londër, Oksford, Dublin dhe gjetkë ia kanë hequr me konsensus mbarëpartiak titujt e nderit të akorduara më parë. Në janar të këtij viti, Muzeu i Kujtesës së Holokaustit në Nju Jork i hoqi asaj dekoratën e lartë “Elie Wiesel” etj.

Edhe *në Amerikën Latine, sidomos në Brazil, Kili, Peru, Argjentinë* dhe gjetkë ka disa liderë(e) të cilët kanë zhgënjyer zgjedhësit dhe popujt e tyre, kur në vend apo në emër të lulëzimit ekonomik dhe demokracisë kanë nxitur dhe prodhuar më shumë përçarje, krim, korrupsion dhe mashtrime gjigante financiare.

Për fat të keq, zhgënjime të tilla tronditëse politike janë ndeshur në shumë raste, ndonëse jo në përmasa të kësaj natyre edhe në Evropë, edhe në Ballkan.

Rast tipik për paaftësi, mungesë të theksuar vizioni dhe guxim politik është ai i ish-*Presidentit francez François Hollande. Në vitin 2012, falë lëvizjes së gjerë “Tani” dhe fitores plebishitare,* Hollande dhe socialistët francezë u ribënë si 3 dekada më parë, pikë e madhe referimi dhe shprese, përballë përshkallëzimit të ethshëm të forcave të ekstremit të djathtë. Mirëpo, pesë vitet e tij në pushtet rezultuan dështim fatal për atë vetë, Francën dhe PS-në e saj. Hollande është i vetmi president francez në detyrë, që nuk guxoi të hynte për një mandat të ri as në garën primare të PS-së nga frika e një katastrofe të vërtetë zgjedhore brenda saj! Për pasojë, PS-ja franceze sot ka vetëm 6 për qind të votave, aq sa detyrohet të shesë dhe selinë e vet, për të shmangur falimentin financiar.

Ka edhe raste kur ky zhgënjim VIP ka ndodhur pas largimit nga pushteti. Në vitin 1998, *Gerhard Schroder* mposhti në zgjedhjet gjermane legjendarin Kohl. Bashkë me Blair krijuan “Rrugën e Tretë ose të Mesme” për rilindjen e gjithë social-demokracisë evropiane; më 2005 humbi fare ngushtë ndaj Merkel në zgjedhjet e parakohshme.

Mirëpo, pikërisht atëherë kur pritej të vazhdonte shërbimin e tij ndaj SPD-së në ato vite të vështira, Schroder u kthye në një problem të madh për politikën dhe imazhin e Gjermanisë. Fill pas largimit nga pushteti, ish-edhe pse financiarisht trajtohet pothuajse si Kancelar në detyrë, Schroder pranoi të emërohej President i Këshillit Mbikëqyrës të “Nord Stream” të Gazprom, falë miqësisë politike personale me presidentin Putin dhe së fundi edhe i kompanisë më të madhe të naftës “Rosneft”, e cila është objekt i sanksioneve të BE-së. Schroder justifikohet se këto funksione të larta janë “punë me kohë të pjesshme”, edhe pse me një shpërblim vjetor marramendës prej 350.000 dollarë. Por, më shqetësues është se veç biznesit, Schroder ka kundërshtuar disa herë përndimin lidhur me mbështetjen e Pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, dënimin e aneksimit të Ukrainës Lindore nga Rusia etj.

Ndërsa në Ukrainë në vitin 2004, ish-presidenti *Viktor Yushchenko* udhëhoqi në fitore “Revolucionin Portokalli”. Mirëpo, edhe lidershipi i tij shumë shpejt pësoi një dështim “ulëritës”. Pas përfundimit me shumë vështirësi të mandatit të parë, ai dështoi në garën për një mandat të dytë dhe në zgjedhjet parlamentare të vitit 2012, ku fitoi vetëm 1 për qind të votave, pa mundur kësisoj të hyjë as në parlament!

Ky dështak i madh, në vend që të bashkonte forcat evropianiste, u përfshi me zell në sherre dhe grindje të vazhdueshme politike me partneren më të ngushtë, ish-kryeministren dhe ikonën e revolucionit “Portokalli”, *Jylia Tymoshenko*. Vijoi me kryeneçësi dhe iu bashkua “korit” të akuzave që e çuan këtë të fundit në burgosjen politike në favor të sfidantit të saj pro-rus, Yanukovych. Gjithsesi, Tymoshenko u shpall e pafajshme nga Gjykata e Strasburgut dhe udhëheq partinë e dytë më të madhe në vend.

Më sipër përmendëm disa nga shembujt pikantë negativë, pa harruar se ka edhe më shumë modele të suksesit emblematik. Prej tyre vazhdojnë të nxirren mësime të dobishme sidomos mbi lidershipin. Më kryesori është se asnjë lider/drejtues, sado popullor dhe karizmatik, nuk është i imunizuar nga rreziku i kthimit në autokrat dhe diktator. Madje, as ndonjë që mund të ketë qenë ose dhe mund të jetë i burgosur politik, i shtypur apo persekutuar.

Garanci absolute ndaj këtyre dukurive të dëmshme për demokracinë e vërtetë nuk jep as integrimi dhe anëtarësimi në BE, NATO etj., ca më pak në vendet ish-lindore, ku siç dhe po ndodh në vende të caktuara, trashëgimia komuniste po kthehet në prirje drejt regjimeve populiste dhe autoritariste.

Mësimi tjetër jetik është se këto zhgënjime “emblematike” shmangen kur forcat dhe liderët politikë nuk e kufizojnë apo identifikojnë demokracinë pluraliste vetëm me votën dhe zgjedhjet e lira, sado të drejta dhe plebishitare qofshin, le më pastaj kur janë me probleme!

Ca më keq akoma kur verdiktin e elektoratit mundohen ta përdorin si “grep” për të kapur pushtetin dhe si “gjethe fiku” për të mbuluar mungesat dhe deficitet në zbatimin e “dekalogut” të Helsinkit - toleranca, konsensusi, lëshimet, kompromisi, respektimi i opozitës, ndarja dhe pavarësia reale e pushteteve, shtypi i lirë, shoqëria civile, OJQ-ve, informimi dhe ndërgjegjësimi publik. Ndryshe dhe alternimi politik, kthehet thjesht në “ndërrim portash”!

Këto dhe të tjera mësime nga pësimet e lartpërmendura nuk ka si të mos vlejnë edhe për drejtuesit e forcave politike në vendin tonë, për ata në pushtet dhe në opozitë, të majtë dhe të djathtë, me përvojë dhe të rinj, të sotëm dhe të nesërm.

Dje në "Deutsche Welle"

Lamtumirë Rumani - frika e politikanëve nga drejtësia

Nga Cristian Stefanescu

(vijon nga faqja 1)

... e vitit 2016 ai u largua nga Bukureshti, pak orë përpara se të dilte urdhër arresti për të. Ditën e arratisë, ai kishte marrë pjesë në një festë Krishtlindjesh të Shërbimit të Brendshëm Informativ Rumun, SRI, bashkë me politikanë të nivelit të lartë e njerëz të drejtësisë e policisë.

ARRESTI SHTËPIAK NË VENDIN FQINJ

Kundër Ghitas zhvillohen hetime për korrupsion, larje parash, shantazh. Pas largimit, autoritetet rumune e kërkuan atë me urdhër arresti ndërkombëtar. Në prill të vitit të kaluar Sebastian Ghitta u arrestua në Beograd. Me një emër tjetër dhe pasaportë sllovene dukej se ai ndjehej i sigurt në kryeqytetin serb. Pas gjashtë javësh paraburgim, autoritetet serbe e liruan atë kundrejt një garancie prej 200.000 eurosh.

Serbia dhe Rumania nuk kanë marrëveshje ekstradimi. Para ekstradimit të mundshëm, drejtësia serbe do të vendosë njëherë për hyrjen ilegale në Serbi, një procedurë që duket se do të marrë shumë kohë.

PASURI DHE POLITIKË

Pasuria e ish-deputetit llogaritet në 100 milionë euro. Pjesa më e madhe e fituar nga pajisja e institucioneve shtetërore me teknologji kompjuterike. Karriera e 23- vjeçarit filloi në provincë, në qytetin jugor rumun, Ploiesti, po me probleme me drejtësinë për pazare të dyshimta. Më pas ai vazhdoi e u ngjit në karrierën e oligarkut kombëtar. Ngjitja erdhi përmes afrimit me Partinë Social-demokrate, PSD. Miqësia me kreun e PSD-së dhe kryeministrin e mëvonshëm, Victor Ponta i siguroi atij kontrata të majme të teknologjisë kompjuterike. Prokuroria rumune shpreh dyshime se Ghitta në pranverën e vitit 2012 ka financuar daljen publike të ish-kryeministrit britanik, Tony Blair në një miting zgjedhor të PSD-së në Bukuresht.

Si shpërblim ai zuri një vend të mirë në listën partiake për të siguruar karrierën politike edhe në parlamentin rumun. Sfondi: si deputet ai gëzonte imunitetin parlamentar. Një imunitet, për të cilin Ghitta ka pasur shumë nevojë, po të kujtosh disa procese të hapura kundër tij. Sipas drejtësisë rumune, proceset kundër tij për shkak të hyrjes edhe në parlament duhet të rihapeshin nga një instancë më e lartë. Por me gjithë problemet me drejtësinë, Ghitta zgjidhet në vitin 2012 sekretar i komisionit parlamentar të kontrollit për shërbimet informative.



SËRISH BEOGRADI

Në dhjetor 2016 Ghita nuk arrin dot të zgjidhet deputet. Autoriteti antikorrupsion DANN kishte zbuluar parregullsi. Një firmë e kontrolluar nga Ghitta kishte siguruar një porosi milionëshe për sigurimin e kufijve serbë. Kreu i qeverisë së Beogradit ishte presidenti i sotëm, Aleksandar Vuçiç. Po ai president që para pak javësh mikun e tij dhe ish-kryeministrin rumun, Ponta e bëri konsulent personal, duke i dhuruar edhe shtetësinë serbe.

Po ashtu, si Ghita edhe Ponta është i përfshirë në disa afera korruptive. Ende Ponta qëndron në Rumani, një vend nga ku nuk janë larguar vetëm politikanë të nivelit të lartë nga frika e drejtësisë. Edhe ish-ministrja Elena Udrea është arratisur në Kosta Rika. Një detaj interesant: Bashkë me të edhe një ish-prokurore rumune ka gjetur vend në Kosta-Rika. Radu Mazare, ish-kryebashkiaku i qytetit-port në Detin e Zi, Konstanta, i dënuar për korrupsion dhe larje parash është tërhequr si "investitor" në Madagaskar. Të gjithë këta persona që janë larguar pa frymë nga Rumania kanë një të përbashkët: ata kanë pasur akses në fondet publike.

Por, të kthehemi tek rasti i Ghitas. Përmes televizionit të tij ai bombardon me "zbulime" dhe sulmon rregullisht institucionet që hetojnë kundër tij nga ekzili beogradas. Vëzhguesit nuk e përjashtojnë një zhvillim të ri: Ghitta mund të jetë një eksperiment për Pontan. Nëse drejtësia beogradase mund të mbrojë Ghittan nga drejtësia rumune, mund të ishte e lehtë edhe për Pontan të presë një vendim të mundshëm të drejtësisë nga ana tjetër e Danubit.

HOROSKOPI

DASHI

Me mbështetje e Jupiterit do të përfundoni me sukses një çështje të rëndësishme, që keni kohë me të cilën merreni. Duhet të jeni mirënjohës për aftësitë tuaja bindëse, nëse një mik ndryshon mendje dhe kthehet t'ju takojë.

DEMI

Planetët në mbrëmje ju dhurojnë një avantazh më shumë. Do të mbizotëroni në skenën profesionale me frymëzim, me shpirtin e iniciativës dhe mprehtësinë e reflekseve. Një takim do të bëjë që të ëndërroni me sy hapur! Emocione të forta do të bëjnë që t'i përjetoni momentet me shumë pasion.

BINJAKET

Kini kujdes dhe mos i hidhni shumë benzinë zjarrit të lojërave të pushtetit dhe keqkuptimeve. Jini të drejtpërdrejtë dhe të sinqertë dhe do të arrini shpejt të gjitha objektivat që i keni vënë vetes. Kërkoni qartësi në raportet në punë tek kontaktet e reja dhe hidhni të zezën mbi të bardhë.

GAFORJA

Do të përballeni me një buzëqeshje me Saturnin, që priret t'ju vështirësojë çdo gjë. Duke qëndruar të gëzuar dhe pozitivë, do t'ia dilni të jepni më të mirën. Në rrethin shoqëror do të jeni tepër të vlerësuar për gjallërinë e nismave tuaja.

LUANI

Bashkëveprimi i planetëve e thekson pasigurinë e provokuar nga Hëna, që është kundra jush dhe kjo ju bën të cenueshëm nga mashtrimet e iluzionit. Pas kërkesave tuaja me ëmbëlsi, partneri do t'ju përgjigjet me nxitim romantik dhe pasionant.

VIRGJERESHA

Gjeste të vogla dhe këshilla të një kolegu më me përvojë nuk do të bien në vesh të shurdhët. Do t'i merrni në konsideratë dhe do t'ju shërbejnë për të bërë zgjedhjet e duhura. Më në fund gjendja juaj ekonomike është në rritje, edhe pse duhet të merreni me angazhime të së kaluarës.

PESHORJA

Mos e sforconi një gjë që ka nevojë për kohën e vet. Mbani në kontroll gjaknxehtësinë, edhe pse një familjar do t'ju çojë në kufi durimin. Në dashuri do të shprehni autonomi dhe besim, por gjithashtu do të tregoni se jeni edhe shumë xheloz.

AKREPI

Me Plutonin që ju vëzhgon tërthorazi, duhet të bëni kujdes ndaj rrëmujës së vazhdueshme që shkakton në organizimin e përditshëm të jetës suaj. Nëse disa çështje do të shfaqen sërish, janë shenja se vështirësitë dhe keqkuptimet nuk janë sqaruar kurrë plotësisht.

SHIGJETARI

Neptuni kundra jep sinjale për ndryshime të mundshme në mjedisin e punës. Mund të ndryshojë disa zakone. Duhet të përballeni me sfida të reja. Është e fortë dëshira për të rilindur, për t'ia nisur nga e para.

BRICJAPI

Hëna në qiellin tuaj përballë Diellit do t'ju verë në provë. Do të zbavitet duke bërë të shfaqen tensione, që zakonisht i mbani nën kontroll. Do të jeni të acaruar dhe aspak tolerantë edhe keqkuptimeve të vogla me të tjerët.

UJORI

Urani do të ndikojë tek ju, duke bërë që të jeni veçanërisht dyshues dhe gjaknxehtë. Probleme të pazgjidhura do të kthehen në qendër të vëmendjes. Duke menduar mbi zgjedhje të bëra së fundmi që ju kanë bërë të lumtur, do t'ju ndihmojë të jeni në humor të mirë dhe të keni vetëbesim.

PESHQIT

Me Saturnin dhe Uranin që ju favorizojnë, do të përfundoni me sukses dhe pa lodhje çfarëdo projekti që ndërmerrni, edhe po të jetë i ndërlikuar. Do të keni një shkëmbim idesh konstruktive me një koleg, që do të ndikojë ndjeshëm tek ju.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Mund të jetë kursimi.
5. Ylli i Nostradamus.
8. Tamam pa kufij.
11. Ross këngëtare.
13. I lashtë.
15. Eshtë Aleanca ku sapoi kemi aderuar.
19. Kufijtë e lëvizjes
20. I ka tek plepi.
21. Paguhen për shërbim.
23. Fillojnë lejen.
24. Kufizojnë trotuaret.
25. Bëjnë karrierë në parti.
27. Thahet me bonifikim.
28. Mund të jetë unik një i tillë .
29. Preka komik shkordran.
31. Fund dhjetori.
32. Fillojnë aksionin.
33. Ente Operative Tiranë
34. Agjenci Ajrore Durrës.
36. Një pjesë e dimensioneve.
39. Eshtë përfaqsuesja e Adriam Mutu.
41. Kalimi në ekstreme.
42. Eshtë e re pas Krishtit.
43. Shkruhet për të mos vazhduar më.
44. Si i gjithë .
47. Kush e thotë lutet.
48. Kufij elementi.
49. Ishte nyja që preu Alekdansdri i Madh.
50. Një pjesë e titanëve.
51. Mund të jetë kundërmuese.
52. Pak titanike.

VERTIKAL

1. Si i përshtatëshëm.
2. Mund të jenë fetare.
3. Ai i kuq e ka një huq.
4. Pak analogji.
6. Eshtë metri i rrobaqepësit.
7. Në hyrje të oazit.
8. Arte pa re.
9. Arthur që qe dramaturg.
10. Janë boshte.
12. Michelangelo regjisor.
14. Mund të bëjë stil të lirë .
16. Ishin monedhe te Tobias.
17. Eshtë bas me katër tela.
18. Pak efikasitet.
22. Eshtë marrëveshje me nota.
25. Ishte babai i Akilit.
26. Fillojnë nazet.
27. Në krye të kuadrove.
29. Eshtë faqe muri.
30. Një apendisit i menjëhershëm.
35. Kurosawa që qe regjisor.
36. Vriten nga espada.
37. Eshtë shtet aziatik.
38. Edouard piktor.
40. Një transporti është kamioni.
45. Uni i Freud.
46. Një cigan.
47. Fundi i një samurai.

Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL

1. Fillojnën panikun.
3. Gibson aktor.
5. Në mes të cogito dhe sum e thën nga Descartes.
9. Mund të jetë trofe.
11. Janë vendet si Katari
14. Maureen që qe aktore.
16. Janë kundërmuese.
17. Mund të fitojnë etapa.
20. Ushtojnë nga "ola".
22. Një thirrje
26. Janë ministritë.
27. Një rrugë në Paris.
28. Markë cigareje.
29. Eshtë nginjja.
32. Ricciarelli soprano.
33. Fillojnë sefte.
34. Ente Ekonomike Sarandë.
35. Mbyllin një ditar.
36. Satelit i Jupiterit
37. I ka tek Luani.
38. Boldi komik italian.
42. Eshtë kolana në filma
43. Kush e thotë lutet.
44. Oxa këngëtare.
46. Inicialet e Nolte aktor.
47. Eshtë tokë që... fitohet.
48. Një... gjermane.

VERTIKAL

1. Një votë në favor.
2. Filozofi me eksperimentin e gomarit.
3. Në hyrje makinës.
4. Fillojnë lehtë.
5. Irlanda në Dublin.
6. Eshtë edhe ajo e historisë.
7. Një pjesë e gamiljeve
8. Notat pa kufij.
9. Ishin komitë.
10. Ka kryeqytet Islamabad.
12. Don... i Interpretuar nga Terence
13. Mbyllin aktet.
15. Janë përmasa.
18. Gjysma e lutjes.
19. Castellitto aktor.
20. Inicilat e Dalí, piktor.
21. Tanita këngëtare.
23. Eshtë trysni
24. Në hyrje të Europës.
25. Janë rrobat për t'u larë.
30. Bën mëza.
31. Moreau aktore.
32. Janë thika.
39. Një pjesë e satelitit.
40. Janë teke në sende.
41. Pak marramendëse.
42. I ka tek zdapi.
45. Inicialet e Nolte-s.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOK

6		5				8	7	
			7	6			4	9
3				9		2	1	
		7			8		3	
4		1	5		2	9		8
	6		9			1		
	1	9		2				4
8	2			5	7			
	4	3				6		5

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

1	9	3	8	4	5	2	6	7
2	8	4	6	1	7	9	5	3
6	5	7	9	2	3	4	8	1
4	2	8	7	5	9	1	3	6
7	3	5	4	6	1	8	9	2
9	6	1	2	3	8	5	7	4
8	1	9	3	7	4	6	2	5
3	4	2	5	8	6	7	1	9
5	7	6	1	9	2	3	4	8

Argëtim filozofik

Nga mjeshtri magjik, Da Vinçi

- Thjeshtësia është sofistikimi më i mirë.
- Të mësuarit nuk e lodh kurrë mendjen.
- Kur përjeton shijen e fluturimit, do ecësh në tokë me sytë nga qielli, atje ke qenë dhe atje do përpiqesh të kthehesh.
- Një ditë e shpenzuar mirë, sjell gjumë lumturie.
- Pengesa më e madhe e njeriut, janë mendimet e tij.

KRIPTOSKEME



KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

S	T	A	R	■	E	T	I	K	E	T	A	T
A	R	M	I	K	■	S	T	O	L	I	T	E
L	I	O	■	R	O	■	M	I	N	A	T	
L	O	■	C	A	B	A	R	E	T	■	L	A
A	■	B	A	T	E	R	I	T	E	■	A	R
T	R	I	M	E	R	I	T	E	■	A	N	E
A	R	T	U	R	O	U	I	■	M	A	T	T
■	A	R	S	E	N	■	■	E	A	■	A	■
A	D	A	■	T	■	M	E	T	R	I	■	C
P	A	K	T	■	P	I	R	A	T	E	R	I
■	K	U	A	L	I	T	E	T	I	■	E	P
L	E	■	C	E	P	I	■	■	N	A	T	A

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALEKRYQI (1)

F	E	R	M	A	N	I	■	T	■	J	■	N	A
A	K	S	I	■	■	L	■	O	V	A	L	E	■
R	O	■	N	E	P	■	F	R	E	N	A	T	■
A	■	H	I	P	O	K	R	I	T	E	T	■	D
■	D	E	M	O	S	T	E	N	I	■	I	K	E
D	I	K	A	S	T	E	R	E	T	■	N	O	R
A	M	A	L	I	A	■	I	Z	E	N	E	■	A
D	E	L	E	■	R	A	■	E	■	O	■	E	■
A	R	I	■	■	E	P	I	T	E	T	E	T	■
I	O	■	M	A	■	I	D	■	M	A	D	H	I
S	R	■	I	R	I	■	E	L	I	R	E	■	N
T	E	R	R	O	R	I	■	A	R	E	N	A	T

FJALEKRYQI (2)

L	U	I	S	■	S	P	■	A	M	A	L	I	A
A	L	■	K	T	■	R	O	B	E	R	I	A	■
P	■	P	E	R	I	O	D	I	K	■	B	N	A
■	F	I	N	A	L	J	A	■	A	A	R	■	N
R	E	P	A	R	T	E	T	■	N	S	I	■	A
■	T	E	R	E	■	K	■	S	I	P	■	■	N
P	A	R	E	T	■	T	R	U	K	E	T	■	I
A	R	I	T	■	R	E	A	L	■	K	U	P	A
S	■	■	■	F	I	T	I	M	E	T	■	■	■
T	A	N	D	E	M	■	N	E	R	E	U	■	R
A	■	H	O	T	E	L	E	T	■	T	R	A	U
J	U	■	K	A	T	E	R	■	■	■	A	R	M

Thënie të mençura

- Nëse asnjë s'të ka zili, dije se ti je njeri i dështuar. Pema me kokrra synohet, tjetra harrohet...
- Njerëzit mund të kalojnë një oqean pa lagur këmbët, por nuk mund të kalojnë kurrë jetën e tyre pa lagur sytë....
- Është më mirë t'i meritoni ndereti dhe të mos i gëzoni ato, se sa t'i gëzoni dhe të mos i meritoni.

(Mark Tueni)

- Grada e qytetërimit dhe moralit të një populli kuptohet nga këngët dhe lojërat e tij.

www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

• Na merrni!
• Na shkruani!
• Na lexoni!

GSH
www.gsh.al

Tashmë edhe lundroni!